



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS

01. NR. 07-4428/15
KLINË, 19.6.2015

PROCESVERBAL

I SEANCËS SË VI-të TË KUVENDIT TË KOMUNËS, MBAJTUR, MË 19.6.2015, NË ORËN 10.00, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e KK, drejtorët e ekzekutivit, komandanti i Policisë në Klinë, Rexhë Berisha, Zyra ligjore, Zyra e Auditimit, OSBE, OJQ-të, mediet etj.

Seancën e udhëhoqi kryesuesi i KK, dr. Haxhi i Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju uroj mirëseardhje në këtë seancë të KK-së. "Rendin e ditës e keni marrë me kohë, hap debatin rreth rendit të ditës".

Skënder Merturi, tha se kam një kërkesë në emër të opozitës, te pika e shtatë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Komunal, kisha kërkuar që kjo pikë të shtyhet për seancën e ardhshme, për arsye se është shumë voluminoze, edhe nuk kemi pasur mundësi që t'i bëjmë përgatitjet e duhura për këtë pikë. "Vlerësoj se është tepër e rëndësishme dhe të ketë debat të thukët për këtë pikë, prandaj ne kërkojmë që të shtyhet kjo pikë për seancën e ardhshme", shtoi anëtari Merturi.

Prend Buzhala, tha se unë sot këtu kam një lajm nga PSHDK. "Presionin që nga fillimi i anëtarësisë së kësaj partie e kam pasur që demokristianët të jenë pjesë e koalicionit. Këtë presion e kam edhe nga Kryesia e PSHDK-së, që kanë bërë në nivel qeveritar, është presion i tyre që demokristianët në Klinë të jenë pjesë e koalicionit për realizimin e projektit. Unë personalisht votë prej tyre kam marrë. Është shtyrë momenti deri tash, janë bërë debate deri tash, janë thënë fjalë kritike e jokritike, miratime e jomiratime, përplasje e jopërplasje deri tash. Dhe ka ardhur një moment që edhe vetë të vendosi për diçka. Çka duhet për të vendosur? A të vendoset që të qëndrojmë kështu personalisht vetë si individ në opozitë dhe të vazhdoj? A të vendoset që të tërhiqem krejt? A të vendoset si individ, apo të miratohet vendimi i një subjekti politik, vendim që edhe për mua vlen, ashtu sikurse vlen edhe për LDK-në në nivel qeveritar, pjesë e qeverisë apo në nivel komunal, pjesë e opozitës apo forcave të tjera politike që bëjnë pjesë e pozitës e tërhiqen dhe prapë kthehen etj., etj., që për mua është e natyrshme dhe jashtë këtij konfiguracionit politik as demokristianët nuk mund të qëndrojnë. Është prapa një elektorat që ka një votë të veten, edhe që i ka vizionet e veta, sepse tek e fundit pluralizmin politik se kam shpikur as unë, por shpresat për demokraci demokristiane janë jo shpikje shqiptare, por shpikje evropiane dhe shpikje e demokracisë evropiane të cilat ne i kemi përqaftuar. Dhe, ky pluralizëm politik e ka atë të drejtën e mendimit të ndryshëm, të drejtën e pajtimit, të drejtën e luftës dhe betejës për projekte. Kështu që, në këtë fazë të fundit, edhe kryesitë, por edhe vetë kam pasur kontakte edhe me kreun komunal, edhe me demokristianët që të afrohen, që të bëhen pjesë e koalicionit. Edhe unë e kam miratuar atë, e mirëpres këtë betejë për projekte, betejën për realizim të këtyre projekteve dhe për mua janë të gjithë të barabartë, për mua janë të gjithë bashkudhëtarë për disa dekada që kemi bërë deri sot dhe e di që secila forcë politike këtu, ka pasur rastin të jetë edhe në pozitë ose opozitë, të jenë pjesë e koalicionit ose jo koalicionit,

prandaj edhe demokristianët janë një subjekt politik. Kështu që unë jam i shtrënguar si i përfaqësuar nga demokristianët që t'i bashkëngjitem këtij koalicioni”, konstatoi prof. Buzhala.

Sokol Bashota, përshëndeti aktin e kalimit të Prend Buzhalës në radhët e koalicionit qeverisës. “E mirëpres vendimin e PSHDK-së t'i bashkëngjitet forcës së koalicionit, ku e ftoj edhe GP të bashkëqeverisjes ta pranojnë një ndër subjektet politik që i ka munguar këtij rreshtimi. Duke i parë edhe orientimet e tyre edhe programore thjeshtë edhe fushatën që është ndjekur nga ky subjekt, unë mendoj se do të ishte një zë i fuqishëm për të krijuar apo për të mbështetur një forcë një subjekt që nesër të dal karshi atyre premtimeve. Unë si kryetar i Degës, por edhe si kryetar i Komunës e mirëpres dhe mendoj se orientimi i PSHDK-së dhe i programeve të tyre, përkatësisht programi i saj do të jetë edhe program të cilin do ta implementojë brenda mundësive që i ka Komuna e Klinës gjithsesi duke qenë në shërbim edhe të qytetarëve. E vlerësoj profesorin Prend edhe për guximin intelektual që po tregon. Ne jemi mësuar këtu ta shohim një ndër zërat më kritikë. Unë jam shumë i vetëdijshëm që edhe brenda këtij koalicioni do të jetë, po ashtu, sepse kritikë gjithmonë te unë kanë shërbyer si udhërrëfim për të realizuar projektet më mirë. Edhe kritikë që marr nga opozita në momentin kur ato nuk kanë qëllime politike dhe tendencioze për mua gjithmonë dhe gjithherë do të jenë të realizueshme dhe do të jenë program imi implementues në interes të qytetarëve”, shtoi kryetari Bashota.

Hali Desku, tha se me profesorin Prend kemi punuar bashkë shumë vite dhe gjithmonë kemi shkëmbyer tone të arsyeshme dhe optimiste për të ardhmen. “Edhe në AK ka ndodhur një gjë e tillë dhe bashkërisht i kemi kontribuar demokracisë parlamentare. Duke menduar tonet e mëhershme që i kemi shkëmbyer për qëllime dhe interesa të qytetarëve unë nuk di ku do të dal profesori i nderuar. Mirëpo, teksa fliste e prisja me optimizëm se nga po dëshiron të dal dhe aty ku doli tregoi vërtet demokracinë shpirtërore dhe intelektuale të tij. Dhe unë e falënderoj fuqishëm nga zemra për fjalët që na i dha dhe për kontributin e tij që do ta vazhdojë i rreshtuar në krah të pozitës, sepse ishte i bindur dhe sot është edhe më fuqishëm i bindur që punët që i ka zhvilluar pozita në krye më PDK-në ishin të drejta, ishin fitimtare dhe është një politikë e vendosmërisë për të ardhmen. Prandaj, unë e falënderoj në emër të Grupit që përfaqësoj dhe me guxim kisha thënë edhe në emër të pozitës, por këta e kanë zërin e vet dhe mund ta thënë ata vetë lirshëm. Ju faleminderit, ju ftoj të zëni krahun e merituar!- shtoi prof. Desku.

Tunë Dedaj, tha se në emër të GP të AAK-së shprehim indinjatë të thellë ndaj shtetit slloven, i cili padrejtësisht e ndalon ish-Kryeministrin e Kosovës, deputetin e Kosovës, Kryetarin e AAK-së, një parti që është parlamentare, e ndalon padrejtësisht pa marrë parasysh që ai në mënyrë vullnetare dy herë ka shkuar në Hagë dhe prej Hagës ka dalë i pafajshëm. “Deri kur populli shqiptar mund t'i durojë këto tortura? Nuk do të thotë që populli slloven ka qenë mik i dikujt, dhe nuk është rasti i parë që i ndalë udhëheqësit tanë politikë, anëtarë dhe komandantë të UÇK-së, por ka qenë edhe “rasti Limaj”, e ka ndaluar edhe zotin Thaçi. E kjo është shumë e keqe që i është bërë Kosovës në këto momente. Unë nuk e di ç'kërkon bashkësia ndërkombëtare të formojë gjykata kur vendimet e gjykatës së vet që i ka, ato të Hagës, që i lëshon njerëzit e vet të pafajshëm, ia ndalon shteti slloven. Dhe Ramush Haradinaj po ju njoftoj se ka udhëtuar edhe në SHBA me atë pasaportë diplomatike që ka pasur, ka udhëtuar edhe në Gjermani, Austri dhe nuk është ndaluar nga askush. Del një republikë e ish-Jugosllavisë që ndoshta ka nostalgji për shtetin ish-jugosllav dhe për Serbinë në këtë moment dhe e ndalon zotin Haradinaj. Prandaj ne shprehim indinjatën më të thellë”, nënvizoi anëtarë Dedaj.

Haxhi Ibishi, tha se besoj se secila parti politike jona do ta respektojë vendimin e Kuvendit të Kosovës, i cili është në të njëjtën valë, në të njëjtën vijë që edhe ju diskutuat. “Unë mendoj, që edhe ky Kuvend distancohet nga veprimi i politikës sllovene dhe njëkohësisht kërkon që delegacioni ynë i cili do të ketë bisedime më 23 të këtij muaj të shtojë çështjen e largimit të të gjitha fletë arresteve të pushtetit serb karshi ushtarëve të UÇK-së, një pushtet që ka marrë të merituarën prej bashkësisë ndërkombëtare, është ndëshkuar prej bashkësisë ndërkombëtare dhe unë mendoj kjo çfarë i ka ndodhur zotit Haradinaj, më herët zotit Çeku dhe zotit Thaçi, Limaj, mund t'i ndodh secilit ushtar të UÇK-së, i cili në dukje ose në arenën publike të Kosovës ndoshta është më pak i pranishëm, por është kontribuues dhe meritues për

çlirimin e atdheut. Unë mendoj që kjo çështje të bisedohet në bisedimet serbo-shqiptare dhe një herë e përgjithmonë kjo çështje të pastrohet. A jeni që KK të Klinës të përkrah në plotni rezolutën e aprovuar në Kuvendi i Kosovës”, shtoi kryesuesi Ibishi.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin.

Propozimi u miratua me vota unanime.

Halil Desku, tha se unë po ndërlidhna me atë me atë kërkesën paraprake të përfaqësuesit “Vetëvendosjes”, që parashtroi rreth rendit të ditës. “Pa i treguar arsytet pse është kjo pikë e rendit të ditës këtu. Unë po e them se kjo pikë e rendit të ditës është më plot arsye këtu, vetëm e kërkoj konfirmimin e Drejtorisë së Urbanizmit. Nëse është gati ashtu siç e kemi kërkuar të procedohet me rendin e ditës, edhe me këtë pikë”, theksoi prof. Desku.

Haxhi Ibishi, tha se është një kërkesë që Skënderi doli në emër të opozitës që pika 7 e rendit të ditës të shtyhet. Ftoj drejtorin e Urbanizmit që të na jap sqarime.

Baki Gashi, drejtor i Urbanizmit, tha se ne jemi të përgatitur për këtë pikë, sepse është edhe Urban Plusi këtu që do të bëjë edhe prezantimin e e PZHK.

Ndue Shabanaj, tha se dola për ta përshëndetur vendimin e PSHDK-së dhe vendimin e këshilltarit të AK z. Prend Buzhala, për t’u rreshtuar në krah të koalicionit qeverisës të pozitës në Komunën e Klinës. “Unë nuk jam ithtar i përkrahjeve dhe i kundërshtimeve të këtilla, megjithatë jam ithtar gjithmonë i veprimeve të hapura pa ndonjë konotacion shumë negativ ose pozitiv të dy drejtimeve. Këtë e kam shprehur edhe paraprakisht dhe dëshiroj për ta shprehur edhe tash. Edhe ky është një argument se subjektet politike në Komunën e Klinës, por edhe përgjithësisht në Kosovë, nuk duhet t’i fryjnë tepër zjarrit të ndasisë në mes të elektoratit në periudhat e ndryshme kohore të zhvillimeve të caktuara politike, për shkak se koalicionet janë plotësisht të natyrshme dhe janë obligative për të krijuar qeverisje në nivel komunal ose në nivel qendror. Të gjitha përpjekjet për të folur ose për të kualifikuar, ose për të vlerësuar herë në një kuptim, herë në kuptimin tjetër, unë mendoj se e kanë arsyeshmërinë politike, por duhet ta kemi parasysh edhe një unitet i cili duhet të ekziston, edhe në kuadër të AK, por në përgjithësi në fushëveprimtarinë tonë politike si anëtar të AK dhe si pushtet”, shtoi prof. Shabanaj.

Haxhi Ibishi, tha se rreth rendit të ditës kemi një propozim nga këshilltari Merturi, i cili foli në emër të opozitës, që pika e 7 të shtyhet. “Është një vendim i Drejtorisë dhe Ekzekutivit që kjo pikë të procedohet”.

Vuri në miratim propozimin e këshilltarit Merturi që pika e 7 të shtyhet për seancën e radhës.

Me 11 pika për, 15 kundër, abstenim nuk ka nuk miratohet propozimi i opozitës për shtyrjen e pikës 7.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e propozuar të ditës.

U miratua ky

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës afatmesme buxhetore 2016-2018,
4. Rishqyrtimi i suspendimit të dy vendimeve të miratuara nga KK për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale sipas kërkesës së MAPL për ndërtim të xhamisë dhe të kishës,

5. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullores për subvencione dhe transvere,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit komunal për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në fshat dhe qytet,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Komunal,
8. Debati lidhur me Fabrikën e Ujit në Klinë,
9. Pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e KK.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi theksoi se ka arsye për anëtarin Ramush Agushi, i cili është jashtë shtetit

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i dy procesverbaleve të seancave të kaluara.

Kryesuesi hapi diskutimin rreth procesverbaleve.

Ndue Shabanaj, tha se rreth procesverbalit kam një vërejtje që një pjesë e tërë e diskutimit në AK nuk është përfshirë fare në procesverbal, që nënkupton, përkatësisht në një formë e lëndon përmbajtjen e diskutimit tim. “Unë jam plotësisht i vetëdijshëm se nuk është me kurrfarë qëllimi, por përpjekja për ta shkurtuar aq shumë dhe për ta bërë ekstrakt i procesverbalit shumë herë e lëndon esencën e diskutimit. Unë e kam përmendur faktin e zvogëlimit të inkasimit të tatimit në pronë dhe e kam ngritur si shqetësim dhe e kemi thënë bashkërisht që në këtë ka ndikuar vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për t’u falë obligimet ndaj qytetarëve për një periudhë të caktuar deri në vitin 2008. Dhe e kam thënë një konstatim tjetër që nuk është përfshirë fare, se Qeveria e R. së Kosovës me aktivitetin e vet duhet drejtpërdrejt ta zbus ndikimin negativ të vendimmarrjes së saj për t’u falë obligimet ose borxhet qytetarëve deri në vitin 2008. Këtë konstatim unë mendoj që duhet për përfshihet në procesverbal, nuk është përfshirë dhe unë mendoj e lë të mangët diskutimin tim dhe përmbajtjen e atij diskutimi”, nënvizoi prof. Shabanaj.

Halil Desku, tha se unë gati ngjashëm me profesor Ndoun, nuk e di kush e ka mbajtur procesin, a ka mbajtur Grisha a Gojani, por një preferencë edhe nga unë që procesverbalin ne e dimë qysh duhet shkruar, nëse na duhet fjalë për fjalë është transkripti, është incizimi, kjo nuk po na nevojitet. “Përmbajtjes nuk duhet për t’i ikur, sepse atë procesverbal e lexojnë, gjegjësisht mund të bie edhe në duar të qytetarëve dhe te të dihet mirë se çka ka folur Halili, çka ka folur Ndou, çka ka folur ai...Unë kur kam folur në debat me drejtorin e QKMF-së i kam prekur tri pika, dua ta bëj publike edhe për ju Kryesues, edhe për Kryetarin, edhe për asamblistët tjerë, se i kam prekur tri çështje për QKMF-në, besoj që edhe të tjerët i kanë prekur ato dhe i kemi prekur ato pikat më të ndjeshme. Kam bërë thirrje për ta ruajtur repartin e gjinekologjisë, sepse kreator i saj është Sokol Bashota, kryetar i Komunës dhe 1 mijë lindje i bëjnë nder këtij që ka hapur atë repart. E dyta, nuk e kam lavdëruar shumë për emergjencën, ekipi i emergjencës është shumë i mirë nuk duhet hyrë në hak, mirëpo i kam treguar se ekipet mobile duhet qitur në terren, edhe i kam bërë thirrje që qendrat klinike në lokalitete për t’i funksionalizuar dhe i kam thënë po qe se këtyre nuk iu përmbahesh jeni keqmenaxhues. Përmbajtjen nuk e kam gjetur në procesverbal”, theksoi prof. Desku.

Tunë Dedaj, tha se në procesverbal nuk janë thënë ato që i kemi thënë ne, nuk janë të shkruara dhe është mirë që dikush mund ta marr dhe ta lexojë dhe të thotë “çka ke thënë ti aty”, sepse nuk e di çfarë kam thënë. Kërkoj që procesi të mbahet fjalë për fjalë për t’u shkruar, sepse po mbetet dokument”, shtoi ai.

Haxhi Ibishi, po shihet se ka vërejtje të shumta rreth procesverbalit dhe nuk po i miratojmë në këtë seancë.

Vlora Tafilaj, tha se edhe unë kam vërejtje rreth procesverbalit, tek fjala ku kam kundërshtuar kolegun Bozhidar, është dashur për të ma cekur aty edhe për punën që ka bërë policia e Kosovës të cilën edhe e

kam çekur që e kanë kryer me përgjegjësi të plotë, sepse siç thanë edhe kolegët e mi parafolës këtë mund ta lexojnë edhe qytetarët dhe ta dinë qytetarët që janë të sigurt në komunën tonë, shtoi anëtarja Tafilaj.

Haxhi Ibishi, tha se po shihet se ka vërejtje të shumta në procesverbal e kthejmë.

Rasim Millaku, tha se kjo shihet që vërejtjet ka përgjithësisht, mirëpo desha të them që ta kalojmë këtë procesverbal, sepse nuk çon peshë shumë, në mënyrë që procesverbalet e ardhshme të vinë komplet, përkatësisht të kërkohet brenda administratës, besoj që ka njerëz profesionistë, do të kthehem në kohën kur e ka punuar Mikeli ka qenë mirë. Prandaj, Kryesues këtë pjesë ta merrni përsipër ju dhe zotohu para nesh se nuk do të ketë vërejtje, se edhe ashtu nuk çon peshë a po e miratojmë apo jo, por në të ardhmen ta kemi më në nivel, sepse nëse i kthejmë dy procesverbale mbrapa dhe një tjetër, që do të thotë tre, atëherë me siguri se do t'i bllokojmë procesmbajtësit", shtoi anëtarja Millaku.

Haxhi Ibishi, tha se plotësisht pajtohem dhe dua t'ju tregoi diçka: Shërbimi i Kuvendit në të kaluarën ka qenë shërbim i veçantë. Shërbimi i Kuvendit sot, unë jam Kryesues i Kuvendit sikur kanë qenë të tjerët, Fadil etj., nuk e kam pjesën e menaxhimit për Shërbimin e Kuvendit. Shërbimi i Kuvendit administrohet prej administratës, çka është edhe një paradoks: mua më kanë dhënë një fletë urdhër ose urdhër administrativ, për ta punësuar një asistent dhe paradoksi shkon ku thuhet, "punësoje nga stafi lokal këtu për të mos rritur numrin e punëtorëve dhe është mandatar dhe rrogën mund t'ia gjesh qysh mund t'ia gjesh!" Ka aq paradokse prej udhëzimit në udhëzim sa që unë mendoj që Mikeli është i përgjegjshëm, në atë shërbim unë një herë nuk kam më të mirë se Mikel Gojanin, në Komunë qysh e kemi situatën dhe do ta shfrytëzojmë Mikelin se këto vërejtje ai t'i shoh sa më shumë në mënyrë që të mos ndoshin më tutje", shtoi Kryesuesi.

Kryesues vuri në miratim procesverbalin më vërejtjet që i thanë parafolësit.

Me vota unanime u miratua procesverbali i dy seancave të kaluara me vërejtjet e dhëna nga anëtarët e KK.

Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës afatmesme buxhetore 2016-2018.

Haxhi Ibishi, tha se i kemi bërë gjitha hapat deri këtu, kemi kaluar nëpër KPF, është bërë debati me publikun, ftoj drejtorin që të na paraqet edhe një herë Kornizën afatmesme buxhetore 2016-2018. "Preferenca e KPF-së ka qenë që të miratohet në këtë seancë të KK".

Ramiz Rrusta, drejtor i FEZH, prezantoi Kornizën afatmesme buxhetore 2016-2018. "E tha edhe Kryesuesi që ne jemi me kohën, e kemi zënë hapin, e kemi pasur edhe në KPF, më 15 të këtij muaji kemi mbajtur debatin me publikun, ku janë prezantuar vërejtjet dhe sugjerimet dhe në bazë të shkresës që na ka ardhur ne si drejtori e FEZH një kopje e kemi dërguar drejtorëve të drejtorive, edhe Kryetarit të Komunës, për hapat që ne bazuar në shkresën numër 951, të dt. 15.5.2015, nga MF, dhe Qarkoren Buxhetore 2016/01 për komuna, t'ju njoftojmë për zhvillimin e procesit buxhetor komunal në pajtim me procedurat dhe kalendarin e përcaktuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi. Kalendarin ka edhe veprimet që kërkojnë proceset buxhetore komunal 2016-2018 është si vijon: Në këtë periudhë themelimi i Kornizës afatmesme buxhetore duhet të dorëzohet jo më vonë se 30 qershor të këtij viti, kur ne duhet për ta dërguar në MF. Besoj që materialin për Kornizën afatmesme buxhetore afatmesme 2016-2018 e keni të gjithë përpara dhe unë do të fokusohem vetëm aty ku janë disa pika kryesore që determinohen dhe që janë faktorë kryesorë për t'u punuar kjo kornizë afatmesme buxhetore për këtë periudhë trevjeçare. Kjo ka të bëjë me perspektivën afatmesme të planifikimit buxhetor trevjeçar", shtoi drejtori Rrusta i cili në vijim foli rreth pikave kryesore që determinohen dhe që janë faktorë kryesorë në Kornizën afatmesme buxhetore 2016-2018. "Para, para vetes keni planifikimin për vitet 2016-2018 në bazë të drejtorive. Në bazë të debatit me qytetarë dhe kërkesave që na kanë ardhur, edhe prej drejtorëve të drejtorive, do t'i prezantoj para juve këtu kërkesat në bazë të drejtorive për investime kapitale. Them se

investimet kapitale për 2016 janë 14.001000 euro”, pohoi drejtori Rusta i cili në vijim potencoi e drejtorive komunale për investime kapitale, si kërkesën e DKA-së, Drejtorisë për Bujqësi për projekte kapitale 2016,2017 dhe 2018, po ashtu edhe drejtoria për Urbanizëm ka bërë planifikimin e projekteve për investime kapitale për tri vitet dhe projektet që kanë dalë prej propozimeve të qytetarëve. Drejtori i potencoi projektet të propozuara). Urdhëroni ju jeni ata që propozoni, ne do t’i marrim propozimet e juaja dhe bashkë me ju dhe Kryetarin do të vendosni se cilat do të jenë prioritetet për periudhën 2016-2018”, theksoi drejtori Rusta.

Avni Gashi, tha se realisht fillimisht do ta bëj një koment se u diskutua edhe në KPF dhe në debat me publikun. “Realisht mua nuk më kujtohet që është diskutuar në KPF, por më duket thjeshtë është tejkaluar. Ky dokument nuk ka qenë prezent në KPF, vetëm në debat me publikun, ku kemi marrë pjesë si qytetarë disa anëtarë të KK. Sa i përket planifikimeve, domethënë të Kornizës afatmesme të shpenzimeve, që na e prezantoi këtu drejtori, realisht ka një devijim bukur të madh prej Kornizës afatmesme të periudhës 2015, 2016 dhe 2017, domethënë disa projekte që kanë qenë të planifikuara më herët ose janë larguar komplet, ose janë tjetërsuar. Dua të ndalem te investimet kapitale: Ndërtimi i shkollës në Jashanicë, e dimë që është në Kërnice, në Përqevë dhe në Këpuz duke u ndërtuar, por jo edhe në Jashanicë, këtu dëshirojmë që të kemi informatat e nevojshme. Në Këpuz dhe Përqevë e dimë për në Jashanicë qenka duke u ndërtuar një shkollë e tretë, apo ku? Desha ta kem vetëm si sqarim. Ndërsa, sa i përket ndërtimit të shkollës në Kërnice shihet që është planifikuar dhe me shumë bukur të madhe. Unë këtu në Kornizën afatmesme buxhetore të shpenzimeve paraprake e shoh se për vitin 2015 kanë qenë të planifikuara të shpenzohen 30 mijë euro për rinovim të kësaj shkolle, ndërsa tani shihet se 350 mijë euro për këtë trevjeçar janë paraparë të shpenzohen në këtë shkollë. Realisht ajo që kisha pasur dëshirë para se ta kisha çuar dorën për ta aprovuar këtë kornizë t’i dimë disa informata rreth kësaj shkolle. Ne të gjithë e dimë se në çfarë periudhash ka kaluar shkolla dhe kur të vjen puna te arsimi sikur te objektet e kultit të gjithë e çojmë dorën dhe nuk jemi askush kundër. Por, realisht çka na nevojitet neve, një analizë e thukët e dokumenteve apo standardeve që kemi nxjerrë prej MASHT-it për ta pasur popullatën e moshës shkollore të kësaj, sa është popullata e ardhshme e moshës shkollore, kur investohen 350 mijë euro, më shumë se 10 për qind e buxhetit; nevojat e ardhshme për numrin e klasave, hartën e shkollës, ndërtesat e nevojshme, vlerësimin, parametrat dhe të gjitha. Krejt çka kemi vërejtur në terren se shkolla e Kërnices është një shkollë e ndarë, paralele e shkollës së Shtupelit, e cila nuk ka më shumë se 100 nxënës momentalisht. Thuhet 140 janë me letra, ose 90, por ne duam ta dimë saktësisht moshën e tyre për secilën klasë. Në qoftë se ne i heqim 700 mijë euro prej shkollës “Tsmet Rraci”, e heqim komplet prej liste, e çojmë në një shkollë krejt tjetër, e cila nuk e ka numrin mesatar, nuk i plotëson këto standarde, fokusin duhet ta orientuar vërtet aty ku dëshirojmë për ta pritur cilësinë, jo vetëm të bëjmë shpenzime dhe ato shkolla sikur ambulancat të na mbesin të mbyllura. Kjo është vërejtja ime kryesore. Sa i përket te shpenzimet kapitale kam edhe disa vërejtje. Kemi folur edhe në debat me publikun, kam marrë vërejtje prej pozitës pse s’po flasim për vendbanim, që kam kërkuar për t’u lidhur rruga Përqevë me Sferkë, po ashtu për të shikuar mundësinë e Gjurgjevikut, që janë jashtëzakonisht keq. Megjithatë, në fshatin Çabiq, ku kanë qenë të parapara për t’u investuar 100 mijë euro për ujësjellës, përderisa ne e dimë që në Sferkë ujësjellësi nuk është funksional, në Dush, Valljak, Caravik; në asnjë prej tyre nuk është funksional, atëherë fillimisht le t’i funksionalizojmë këta ujësjellës që kemi në mënyrë që të krijojmë hapësirë. Prandaj, le të jetë kërkesë imja që këto 100 mijë euro të mbesin qysh kanë qenë të planifikuara për fshatin Çabiq për buxhetin e vitit 2016 me ridestitim, dy rrugë kanë mbetur pa u shtruar asfalt prej të gjithave. Njëra është jashtëzakonisht keq që ka nevojë urgjente, jo një ditë para zgjedhjeve të shkojë një kamion rërë apo dy, por definitivisht për t’u shtruar në asfalt, kjo është veç për t’u destinuar, të hyjë në buxhet. Këto janë komentet e mia që kanë të bëjnë me Kornizën afatmesme 2016-2018”, nënvizoi anëtarë Gashi.

Skënder Merturi, tha se do të bëj përpjekje që të shkoj rend, ndoshta me numra nuk mund t’ia qëllojmë, mirëpo drejtorin e kemi këtu për shpjegime. “Te tab. nr. 1: Planifikimi ekonomik komunal, popullsia komunale, nuk e di, 2015,2016,2017, 2018, i ka dalë i njëjti numër i popullsisë së Komunë, nuk e di qysh

e kanë llogaritur këta, edhe të numrin i nxënësve, ka dalë pothuaj i njëjtë, gjegjësisht nuk ka ndryshim të numrit, te tab. nr. 1. Faqe nr. 7, nuk e kam të qartë: "certifikata të tjera", ku janë ato "certifikata të tjera", ku janë 18 mijë euro të planifikuara? Cilat certifikata mund të jenë? Edhe një nuk e kam të qartë, fq. nr. 8, te gjobat nga gjykatat. Çfarë është menduar me këto "gjobat prej gjykatave" Në fq. nr. 9 po shihet, tab. nr. 6, po shihet se pagat dhe mëditjet janë në rritje, ndërsa unë di që granti i Qeverisë ka me i vogël nëse nuk gaboje. Edhe te subvencionet ka rënie, në mos kishte qenë mire për të na treguar për subvencionet kah shkojnë më shumë, këtu është fq. nr. 10. Për ta pasur një listë kah shkojnë subvencionet më shumë, edhe ka qenë mirë të certifikohet se cilët qytetarë përfitojnë në një farë mënyre pak më shumë prej subvencioneve. Dhe kjo më kryesorja, f. 15, ne atë ditë e kemi diskutuar dhe vetëm diçka desha për të sqaruar, ne nuk jemi kundër ndërtimit të shkollave, të rrugëve, por po me duket që kjo shkolla e Kërnics na ka vënë në dilemë, a është e nevojshme ndërtimi i një shkolle të re ose të rishikohet mundësia e rinovimit të asaj shkolle, a na shërben në kohën afatgjatë të kjo ndërtimi i shkollës në Kërnics, edhe unë kam një propozim konkret: a është mundësia që ndërtimi i shkollës "I. Rraci", që është shumë e nevojshme të shkohet në participim me donatorë. Unë e kam menduar 1 milion euro 2016 dhe 1 milion euro 2017, edhe të shikohet mundësia edhe granteve prej Qeverisë për ndërtimin e kësaj shkolle, të paktën fillimisht të fillojmë ne vetë, pastaj vinë edhe të tjerët dhe do të na kishin ndihmuar. E kam edhe një propozim konkret, që është shumë i nevojshëm për qytetarët e Klinës, të shikohen mundësitë buxhetore, ndërtimi i një stacioni të autobusëve. Ne e dimë që më herët ka qenë, atëherë nuk kam qenë pjesë e kësaj Asambleje, por më herët është ndarë një shumë për ndërtimin e stacionit të autobusëve, por akoma nuk është marrë parasysh dhe është hequr dhe nuk e dimë çfarë është bërë me atë projekt. Këtu ku e kemi ujësjellësin në fshatin Bokshiq, është menduar për 2017, mendoj që do të kishte qenë mirë të përfshihet për 2016, edhe kanalizimi në fshatin Zllakuqan, është menduar për 2017, është mirë të dal në 2016; furnizimi me ujë në lagjen Temaj, në Shtupe, kam menduar që me një shumë prej 10 mijë euro, do të kishte mundur të kryhet. Asfaltimi i rrugës në Gjurgjevikun e Madh është tepër e nevojshme; asfaltimi i rrugës Radulloc, edhe këtu ku është menduar për ndërtimin e tendave të ujitjes 50 mijë euro, në mos do të kishte qenë më mirë të shkohet në rrjetin e ujitjes Grabanicë në qendër dhe të Ukë Sahitët, edhe të Lumajt në Këpuz; furnizimi me ujë edhe 110 mijë euro nëpër fshatra të Klinës, po dihet se ka rrjet të shtrirë të ujësjellësit, por nuk funksionon për shumë arsye dhe në bazë të bisedave që kemi pasur me ata të ujësjellësit në shumë vende nuk funksionon rrjeti i ujësjellësit që ka komuna e Klinës. Do të kishte qenë mirë dhe të bëhet një analizë, et ai rrjet, edhe një shumë e caktuar e këtij buxheti për 2016 dhe 2017 të shkojë të paktën në rinovim ose të shihet ku janë ato mundësi edhe të bëhen atom përpjekje për përmirësimin e rrjetit, ndërsa ujët, tash do të kemi edhe temën e Fabrikës së ujit. Këto do të ishin pak a shumë vërejtjet e mia lidhur me këtë", theksoi anëtarë Merturi.

Halil Desku, tha se fillimisht dua ta përshëndes drejtorin e FEZH-it me prezantimin e Kornizës afatmesme buxhetore, dhe në emër të GP të PDK-ë edhe e mbështesim këtë. E trajtova në atë mënyrë që kjo kornizë ia vlen të miratohet, mirëpo nuk e përmbyll diskutimin tonë, nuk i përmbyll kërkesat tona, dhe nuk e përmbyll begatimin e saj. Tash në emrin tim personal dua të flas për disa projekte. Siç vërejtja, për mua është lajm i gëzueshëm ndërtimi i Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Klinë, që është e paraparë në vitin 2018, është pak larg, mirëpo më mirë vonë se asnjëherë. Ky projekt duhet të jetë edhe standard evropian. Farë po që se nuk është standard evropian na nevojitet neve për mirëmbajtjen e shëndetit publik. Mirëpo, për të ardhur deri te ky impiant në vitin 2018, mendoj që paraprakisht komuna e Klinës duhet të mbulohet krejt me ujësjellës, me kanalizime. Ne e dimë që çdo ujësjellës që është ndërtuar, por e do pastaj edhe kanalizimin, sepse ka derdhje të ujit dhe kanalizimet vërshojnë. Unë po shoh këtu që nuk janë disa fshatra, disa anë të qytetit, të përfshirë sidomos në kanalizime. Të punohet me hapa të përshpejtuar në ndërtimin e këtyre kanalizimeve. Sepse në disa fshatra jemi në prag të shfaqjes së epidemive. Me duhet ta potencoj fshatin tim, është mirë të potencohen edhe fshatrat tjerë. Ne fshatin tim ka pasur paraqitje te epidemisë prej kanalizimit, jo shpërthim por rast sporadik. Nuk po e shoh që në këtë fshat është kanalizimi as më 2018", shtoi prof Desku.

Haxhi Ibishi, ne nuk jemi duke biseduar për projektet, është një kornizë e mesme, prandaj ne kemi buxhetin për secilin vit që miratojmë, ju kisha lutur që në këtë domen për ta bërë diskutimin.

Halil Desku, tha se kam edhe një çështje tjetër: projekti i kanalizimit në Siqevë le të jetë i përfshirë në strategji edhe në qoftë më 2018, me mundësi të realizimit ndoshta edhe më 2015,. Është një indinjim te secili qytetar nëse shkon ky dokument dhe sheh që deri më 2018 nuk paskam kanalizim. E dyta, është e paraparë rinovimi i shkollës “L. Gurakuqi” në vitin 2017 me 200 mijë euro, rinovimi pret edhe më 2018, këtu është në pyetje avaria e ngrohjes qendrore . Duhet ditur si të gjenden burimet financiare për sigurimin e ngrohjes së shkollës. Tetori po vjen dhe po që se nuk ngrohet shkolla do të ketë bojkotim mësimi, jo bojkotim, por nxënësit doemos duhet çuar në shtëpi. Nesër të mos thotë kjo asamble kur nxënësit nuk shkojnë në shkollë “qysh nuk e kemi ditur”. Ngrohja e kësaj shkolle është prioritet mbi prioritete ”, tha prof. Desku.

Pjetër Coli, tha se desha së pari të përkrah propozimin e Skënderit për shkollën “Ismet Rraci” në Klinë, që vërtet të hulumtohet çdo mënyrë e mundshme që ajo shkollë të niset, edhe unë personalisht jam i gatshëm që të jap një kontribut, të gjejme donatorë, që ta ndihmojmë ndërtimin e asaj shkolle sa më shpejt, është ndoshta e vetmja shkollë në komunën tonë ku numri i nxënësve është në rritje e sipër vazhdimisht. “Disa shkolla e dini fort mirë se kanë rënie të numrit të nxënësve, siç u potencuar Kërnica, nuk është e vetmja, janë edhe shkollat tjera. Dua të ceku edhe një projekt tjetër shumë i vogël, në lagjen e Përlinave, prej stacionit të policisë në dalje të qytetit, d.m.th. janë asfaltuar të gjitha rrugët, ka mbetur vetëm rruga e te lagja Gjinaj dhe Ndrecaj e paasfaltuar. Kisha propozuar që të hyjë në prioritet të asfaltimit, është një rrugë prej 300 metra dhe do të ishte lehtë e realizueshme. Disa herë e kam potencuar, meqë Përqeva i takon BL-së të Sferkës, aty është e domosdoshme një rrugë e kalueshme, sepse ata njerëz prej Përqeve duhet ardhur deri në Dollc dhe të ngjiten Volljakut përpjetë deri në Sferkë. Domethënë është e pakuptueshme që për 3 km për të bërë gjithë atë rrugëtim për një certifikatë, bie fjala. Prioriteti numër një për mua, është një rrugë e cila e ndanë një region, kjo është rruga Shtupel - Ranoc. Grapci, Binxha, Shtupeli, Kërnica, të cilët duan të shkojnë në Zllakuqan ose Istog ata duhet të vijnë deri në Klinë për të vazhduar për atje. Aty janë maksimalisht 3.500 metra, e kam matur disa herë, është në gjendje të pakalueshme sidomos kur ka të reshura. Ajo rrugë kishte për ta lidhur regjionin të cilin e potencova më parë të këtyre fshatrave me regjionin e Zllakuqanit. Sipas vlerësimit tim ky është prioriteti numër një sa i përket asfaltimit të rrugëve”, theksoi anëtar Coli.

Lorenc Marleku, tha se unë do të prezantoj shqetësimin e banorëve të lagjes Përlina, ku vetëm një shi i vogël, aty kanalizimi depërton në rrugë dhe bien poshtë. “Aty nevojitet një kanalizim prej 300 metra. Po ashtu edhe rrugën e kanë në gjatësi prej 300 metra, e cila ishte dashur të rregullohet. T’i thuhet dikujt që s’ka kanalizim apo ujësjellës, është e pajustificueshme. Ne kemi mbetur që 15 vjet duke bërë përpjekje për të bërë kanalizime, por prioritet ishte dashur të jetë qyteti, sepse aty ka një dendësi të madhe të shtëpive dhe nuk ishte dashur assesi për të lejuar të mos ketë. Pra, edhe rruga edhe kanalizimi janë në gjatësi prej 300 metra dhe komuniteti është në gjendje të bashkë financojë, por nuk është marrë parasysh. Tash t’ju themi atyre se deri më 2018 nuk ka diskutim puna e kanalizimit nuk dimë çfarë mund të flasim me ta. Rruga në Krushevë të Madhe në lagjen e Dodajve, edhe ajo është në gjatësi diku 1 km, ata para një viti kanë bërë një kërkesë, por nuk u është dhënë asnjë përgjigje, edhe rruga e Stupës, edhe ajo është diku 900 metra. Ne nuk mund t’u themi atyre që s’jeni as më 2018 në plan”, theksoi anëtar Marleku.

Bozhidar Sharkoviq, tha se vetëm kam dashur të pyes se a është definitive regjistri e këtyre projekteve për këto tri vite, pasi që nuk po vërej asnjë projekt i paraparë në ato lokalitete ku jetojnë komuniteti serb, ku ka edhe komunitete të përziera. “Nga ky aspekt, kam dy propozime konkrete: kanalizimin në fshatin Videjë, ku jetojnë mbi 100 familje të komuniteteve të ndryshme. Dhe projekti i dytë është rregullimi i rrugës për fshatin Grapc” shtoi ai.

Hasime Dauti, tha se desha për t’ju përgjigjur zotit Gashi. “Sa i përket shkollës së Kërnicsë, sepse që 2-3 herë përmendet stafi i saj, pikërisht nga zoti Gashi, numrin e nxënësve tani për tani e ka 145 nxënës dhe

në shtator pritet që ky numër të rritet edhe për 30 të tjerë. Numri i këtyre nxënësve në të shumtën e rasteve ka rënë edhe shkak i objektit shumë të dobët. Do të kishte qenë mirë ta shihni dhe ta verifikoni gjendjen, pastaj të flisni. Ka qenë një ekip dhe ka vërejtur se nuk i plotëson kushtet për fëmijë kur ndodh që gjatë procesit mësimor nga dyshemeja në të shumtën e rasteve dalin edhe minj, mos të flasim për tualetet që nxënësit e kësaj shkolle shfrytëzojnë pyllin për nevoja të ndryshme të veta”, theksoi anëtarja Dauti.

Haxhi Ibishi, tha se kjo AK ka marrë vendim para tre-katër vjetëve, që komuniteti që participon me 20% e më tepër të ketë prioritet. “Domethënë pavarësisht prej asaj, ky është një projekt-propozim e kornizës, e cila prapë kjo AK secilin buxhet kalendarik i ridestimon mjetet e veta”, shtoi Kryesuesi.

Vlora Tafilaj, tha se desha për t’ia bërë një pyetje drejtorit të financave që në Planin afatmesëm të buxhetit komunal për investimet kapitale të programit 2015-2017 ka qenë projekti për asfaltimin e rrugës në fshatin Poterq dhe keni ndarë një buxhet prej 150 mijë euro, atëherë pse ky projekt nuk ekziston në Planin afatmesëm të buxhetit komunal, ku ka mbetur ai plan dhe ku kanë mbetur ato 150 mijë euro të cilat kanë qenë të destinuara për këtë projekt, shtoi anëtarja Tafilaj.

Rasim Millaku, tha se fillimisht kisha thënë se edhe pse këtu shihet vetëm një draft, mirëpo një draft i cili lë gjurmë për fillimin e një pune. “Kisha thënë se nëse një pozicionim apo një projekt i cekur në vitet kalendarikë që kemi këtu 2016-2018, është shumë më vështirë për ta hequr atë projekt, qoftë ai që ka shkruar, ekzekutivi, se sa për të futur një projekt të ri, domethënë për ta hequr është një punë shumë e zorshme. Do të ndalem në përpilimin e këtij teksti. Në përpilimin e këtij teksti, shuma për vitin 2016, i përmendem edhe nëpër kategori edhe nëpër projekte konkrete me emra dhe rezultojnë saktë 1.401.097,00, ndërsa për vitin 2017 dhe 2018 këto shuma nuk janë, do të thotë nuk janë mbledhur mirë, për vitin 2017 shuma e tyre është 1.504.000,00 e nuk është 1304.207,001, dhe me syrin e thjeshtë del që 1 mijë euro në fund aty të shumës nuk është askund, edhe në vitin 2018 akoma më keq, shuma e tyre është 1.108.000, e jo 1.450, 000, të gjitha këto janë gabime teknike. Ajo që dua të them dua të dal lokalit si gjithmonë, Halili e filloi, por e la në gjysmë, ne të gjithë kemi përgjegjësi elektorale prej rajoneve nga vijmë edhe bashkë me neve kemi dhënë përgjegjësi këtij ekzekutivi dhe Kryetarit tonë të nderuar, bashkë me besimin tonë domethënë kemi ndihmuar këtë ekzekutiv që të qeverisë. Përmendja e disa projekteve për çdo respekt, mirëpo mos përmendja e projekteve nga bashkësia lokale e Ujëmirit për mua është e papranueshme. Dua të kthehet në mënyrë retroaktive një vit prapa kur kemi diskutuar për projektet për këtë vit që jemi, pra për 2015, një vit më herët kam bërë vërejtje se nuk shoh asnjë projekt, qoftë edhe sado të vogël, duke u lidhur nga një urë, që një lagje e tërë është e bllokuar dhe kalon, po ashtu duke filluar prapë nga një rrugë e të së njëjtës lagje që nuk mund të kalohet as gjatë verës, gjendja e shkollës këtu është shumë e keqe, gjendja teknike, disa lagje janë pa rrugë, mirëpo një lagje është e bllokuar. Në Siqevë e potencoi edhe Halili kemi rastin e kanalizimit që paraqet edhe përhapjen e epidemisë, ndërsa kemi një lagje të tërë të bllokuar për rrugë dhe shumë projekte të tjera minore. Në Shtaricë nuk ka kanalizim, fshati Shtaricë me fshatin Ujëmirë komplet qindra nxënës kalojnë një rrugë shumë të rrezikshme, projekt i një trotuari i prezantuar disa herë, në Dobërdol asnjë projekt, nuk ka ujësjellës, Çabiq nuk ka ujësjellës dhe të tjera që nuk do t’i numëroj. Kam të drejtë për t’u mos u pajtuar, dhashë se mbaj përgjegjësi dhe nëse ne nuk e ngrehim zërin për të mirën e qytetarëve që kemi marrë besim në formën vetanake dhe bashkërisht edhe me Kryetarin tonë, sepse kemi qenë bashkërisht në fushatë, nuk di çfarëdo t’u themi BL-së së Ujëmirit kur 2014 shkoi pa projekte, 2015-ta pa projekte, 2016 asnjë dhe 2017-2018 është një ujësjellës në fshatin Çabiq. Edhe pse e di që kjo nuk është pikë, por pak a shumë zëri ynë nuk po përfilllet, sepse ai lokaliteti i Ujëmirit është një nga meritoret për të qeverisur Kryetari ynë bashkë me gjitha strukturat tjera qeverisëse dhe kemi për detyrë që unë bashkë me Halilin që vijmë nga ai lokalitet të jemi më kërkues në këtë asamblë. Ky dokument ka edhe vërejtje teknike, por vërejtjet teknike nuk çojnë peshë, nga ajo që nuk është përfshirë BL-ja e Ujëmirit”, ka konstatuar anëtari Millaku.

Avni Gashi, tha se unë nuk kam kërkuar për t’u ndaluar ky projekt për shkollën e Kërnicsës, por kam kërkuar sqarime qysh e duan edhe normat që janë për të ndërtuar një shkollë. “Është e dhimbshme që

shkolla fillore "Ismet. Rraci", të hiqet komplet nga Korniza afatmesme të shpenzimeve, ndërsa të kalojë në një shkollë tjetër, kur ne e dimë nevojën dhe numrin e nxënësve që është në shkollën fillore "Ismet Rraci". Edhe në debat me publikun, edhe tani kemi kërkuar numrin, të paktën të kemi informata, edhe dy muaj do të vjen për aprovim për buxhetin për 2016. Ne duhet për t'i pasur informatat, numrin e nxënësve, ata nxënës në sa shkolla gravitojnë, sa vijnë në shkollën e Kërnices etj. Kam informata që nxënësit e Kërnices shkojnë në shkolla tjera, si në Klinë, Jashanicë, Shtupel, jo krejt për shkak të kushteve të vështira. Në Kornizën afatmesme të kaluar janë ndarë 30 mijë euro për rinovimin, rinovimi domethënë ka qenë për rregullimin e tavanit, WC-ve e kështu me radhë janë ndarë 30 mijë euro. Pse nuk janë investuar ato 30 mijë euro dhe pritet për t'u investuar 350 mijë euro është çështje tjetër. Ne nuk po themi që jemi kundër, por po kërkojmë të na sqarohet saktësisht sa nxënës ka, kush graviton aty, në mënyrë që të rritet cilësia e shkollës, e jo të na shkojë mendja e keqpërdorimeve. Kur të na vinë ato informata e çojmë dorën edhe e aprovjmë edhe atë për shkollën", shtoi anëtarë Gashi.

Arben Limani, tha se ne si GP mendojmë që është shkelje procedurale, edhe vënia e asaj pikë në rend të ditës, pasi për këtë pikë nuk është diskutuar në KPF, çka është edhe procedurë për të kaluar nëpër KPF dhe të diskutohet për çështje financiare. "Desha ta përforcoj mendimin e Avniut dhe të parafolësve tjerë, për planifikimin jo të drejtë dhe jo të qëlluar mbi zhvillimin e infrastrukturës nëpër shkolla. Të mos synohet të investohet shuma të mëdha nëpër shkollat të cilat kanë numër të vogël të nxënësve, pasi edhe vetë jam punëtor arsimit dhe e di që nëpër fshatra pothuajse në çdo fshat numri i nxënësve po bien për 20-30 për secilën shkollë. Ne jemi që këto shkolla të vogla të rinovohen dhe t'u krijohen kushte normale për mësim, ndërsa të investohet 350 mijë euro për një shkollë me 130 nxënës për ne nuk është e arsyeshme. Nuk jemi kundër ndërtimit, normalisht se përmirësimi i infrastrukturës shkon në ngritjen e cilësisë të mësimdhënies dhe mësimnxënies, por politika e orientimit të këtyre investimeve është e gabuar", nënvizoi anëtarë Limani.

Tunë Dedaj, së pari kisha kërkuar nga kryetari i Komunës, Sokol Bashota dhe zv. ministrit Fadil Gashi, që të angazhohen të dytë me ndikimin e tyre, që edhe qeveritë i udhëheqin bashkë, kisha kërkuar prej tyre një angazhim edhe më të madh që shkolla fillore "Ismet. Rraci", të ndërtohet dhe të kryhet sa më shpejt. "Rreth Kornizës afatmesme buxhetore të Komunës së Klinës, për herë të parë e shoh një kornizë gjithëpërfshirëse, do të thotë të gjitha anët e lokaliteteve tona janë të përfshira, me ç'rast e falënderoj edhe drejtorin e Ekonomisë, edhe Kryetarin dhe gjithë ata që janë angazhuar, prandaj mua po me pëlqen dhe e përkrah", shtoi ai.

Halil Desku, tha se unë e di çfarë do të thotë "Kornizë afatmesme buxhetore". "Dua ta bëj një sqarim: tri vjet radhazi shkruhen 3-4 kanalizime dhe mbesin 7 apo 8 të tjera të gjithë shqetësohen po që se vjen dokumenti dhe e shoh qytetari dhe indinjohej. "Prandaj, ose për t'i përfshirë të gjitha kanalizimet për tre vjet ose të shkruhet projektet e kanalizimit për vitin 2017 dhe pastaj i definojmë nëpër fshatra. Sa i përket atë që tha Rasimi: unë nuk e lashë asgjë në gjysmë, e dëgjova në tërësi dhe të gjitha projektet e këtij lokaliteti i kam të shkruara. Për Ujëmirë është bërë, po do të bëhet akoma", shtoi prof. Desku.

Marije Selmani, tha se Skënderi potencoi fshatin tim dhe të gjithë bimë në pozitë shumë të ulët, megjithëse e kam potencuar shumë herë, por asgjë nuk është ndërmarrë konkrete. "Po më vjen mirë për të gjitha këto projekte të shumta që po bëhen në të gjitha fshatrat. Nuk jam kundër asnjë projekti, mirëpo është mirë që të bëhet balancimi, që do të thotë asnjëherë nuk po përfshihet ky fshat. Ka nevojë për asfaltimin e rrugës, kur bien shirat aty krejt rrëshqet toka, po ashtu edhe për kanalizim. Domethënë këtu asnjëherë asnjë investim nuk është bërë. Po vërej që në të gjitha fshatrat ka investime të ndryshme, këtu asnjëherë", shtoi prof. Selmanaj.

Ndue Shabanaj, tha se përshëndes këtë Kornizë afatmesme buxhetore, natyrisht se nevojat janë shumë të mëdha, mirëpo mundësitë shumë të kufizuara. "Dhe realisht mendoj se edhe në këtë Kornizë afatmesme buxhetore janë përfshirë disa fshatra që realisht nuk kanë realizuar paraprakisht projekte ose investime kapitale asnjëherë. Unë përshëndes një përfshirje të këtillë dhe një shpërndarje proporcionale, ndonëse ka

edhe shumë fshatra të tjera që gjithashtu kanë nevoja dhe kanë projekte të parealizuarasnjëherë. Ne nuk mund t'i fusim të gjitha përmjërë, duhet të lejojmë një mundësi dhe një prioritet i cili është i nënkuptueshëm dhe i cili realizohet sipas mundësive buxhetore të Komunës. Por, orientimi për t'i përfshirë të gjitha dhe shpërndarja proporcionale është për t'u përshëndetur. Gjithmonë ka nevoja më shumë se sa ka mundësi, dhe orientimi i këtillë krijon mundësinë që për një të ardhme të afërt edhe të tjerat për t'u përfshirë dhe natyrisht kjo është pika më e ndjeshme për një anëtar të AK. Secili prej nesh kemi një votë, kemi një besim të marrë nga qytetarët, dhe dëshirojmë për ta arsyetuar, dëshirojmë për t'i arsyetuar premtimet që i kemi dhënë para elektoratit. Këtu duhet të bisedojmë jo si subjekte politike, jo si merita individuale, është meritë e pushtetit lokal, është meritë jona e përbashkët dhe është natyrisht një angazhim i përbashkët edhe i AK edhe i Ekzekutivit", konstatoi prof. Shabanaj.

Sokol Bashota, tha se nuk dëshiroj të bie në kurthin e lokalizmit aq shumë për arsye se ne nuk jemi të ndarë në zona elektorale, është një zonë e tërë, dhe të gjithë asamblastët duke përfshirë edhe ata të partisë që përfaqësoj i kam vërejtur edhe në Caravik duke kërkuar votat, edhe në Zllakuqan, Bokshiq dhe Sferkë, domethënë nuk e keni kërkuar vetëm nga vini dhe tash keni besimin tuaj. Një buxhet çfarë e dini, çfarë është. Janë bërë përpjekje që të bëhet gjithëpërfshirëse, ndoshta më mirë do të kishte qenë të potencohen vetëm si projekte pa ditur ku, për arsye se, prapë ju jeni ata të cilët keni për te vendosur për secilin projekt. Kjo është vetëm një kornizë njëherë, e cila përmes Drejtorisë për FEZH, ndoshta edhe po e keqpërdor zv.ministrin Gashi këtu, për ta shtyrë që të mos na sjellët nga Qeveria para aktit të kryer dhe në një afat tepër të kufizuar kohor, për të mos pasur mundësi ndoshta as për ta trajtuar në KPF, apo edhe më gjerë, ju si asamblastë dhe ne si ekzekutiv, prandaj do të kishte qenë mirë që më herët të ishte dërguar. Po e ripotencoi: keni për t'i diskutuar vetë dhe ne ju kemi ofruar asamblastëve për miratim. Të gjitha takimet që kemi pasur individuale me qytetarë, në emër të fshatit, kërkesën e bordit, të drejtorive veç e veç dhe debatit me qytetarët kanë ardhur këtu, prandaj ju do të jeni ata që keni për t'i përzgjedhur këto investime dhe keni për t'i emërtuar. Është dashur për t'i qitur disa korniza, nuk dëshiroj ta keqpërdor Rasimin, për Dobërdol janë 250 mijë euro, domethënë procedura është tenderuar. Prandaj mendoj që lokaliteti i Ujëmiri nuk është mënjeluar. 54 fshatra nuk kanë mundësi për t'i marrë nga 250 mijë euro. Edhe kjo ndarja që po bëhet kështu me donatorë, edhe Dobërdoli, kanë participuar me 30 mijë euro. Mendoj që mendoj që kornizën duhet për ta votuar, pastaj ta keni të sigurt se këtu keni për ta pasur", konstatoi kryetari Bashota.

Kryesuesi vuri në miratim Kornizën afatmesme 2016-2018.

Me 17 vota për, 3 kundër dhe 6 abstenime u miratua Korniza afatmesme buxhetore 2016-2018.

Pika e katërt: Rishqyrtimi i suspendimit të dy vendimeve të miratuara nga KK për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale sipas kërkesës së MAPL për ndërtim të xhamisë dhe të kishës.

Kryesuesi Ibishi sqaroi në mënyrë kronologjike çështjen në rend të ditës. Hapi debatin.

Haxhi Ibishi, tha se na është dhënë sugjerim që të rishqyrtohet vendimi edhe një herë, të abrogohet ose të suspendohet për kohë të pacaktuar derisa të arrihen dy qëllime nga ekzekutivi. "Është thënë që definimi i pronës të ndërrojë te dy ngastrat dhe të dy pronat të qiten në ueb faqen e Komunës. Unë në sugjerimin edhe prej shefave të GP edhe KPF-së kam bërë një takim me dy përfaqësuesit të komuniteteve fetare, jemi dakorduar të gjithë që t'i përshpejtojmë hapat derisa vendimi të jetë krejtësisht valid në aspektin ligjor.

Halil Desku, tha se i kemi shterë të gjitha mundësitë rreth kësaj çështjeje, dhe për ta zgjidhur këtë problem e kemi diskutuar në KPF, po ashtu edhe me klerin katolik dhe atë mysliman dhe të gjitha nënkuptojnë se kjo duhet përshpejtuar dhe ne jemi në funksion për përshpejtimin e procedurave të kësaj çështjeje.

Arben Limani, tha se në si Grup Parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtuar kërkesën që është bërë për rishqyrtim suspendimin e dy vendimeve të miratuara nga KK, meqë është dhënë vërejtje nga MAPL dhe do ta mbështesim kërkesën që është bërë edhe nga bashkësitë fetare, por ashtu edhe kërkesën që është bërë nga KK.

Tunë Dedaj, tha se desha si vërejtje që Zyra ligjore ishte dashur për ta ditur më herët se a kemi pasur apo nuk kemi pasur të drejtë për të votuar në atë mënyrë për t'i dhënë ato prona apo jo. "Shpesh po biem në kundërshtim me ligjin. Unë e di që Kuvendi i Komunës është organi më i lartë që bien vendime për Komunën e Klinës dhe nuk është mirë për të na qitur në këso lajthitje, se qytetari nuk e kupton kështu siç e kuptojmë ne sot këtu, ata e kuptojnë shumë më ndryshe. Kisha për të kërkuar për t'u shpejtuar ato procedura, e përkrahim edhe ne si GP i AAK-së", u shpreh Dedaj.

Haxhi Ibishi, theksoi se kjo asamble që është thirrur kështu është në funksion të shpejtimit të procedurave.

Skënder Meturi, tha se është hera e dytë që po sjellim këso vendimesh dhe po bimë ne lajthitje. "Hera e parë ka qenë vitin e kaluar kur i kemi ndarë tokat për ndërtimin e disa shtëpive për komunitetin rom, shkali dhe serb. Unë jam për, por ajo çka insistoj unë ta kemi një rregullore për shfrytëzim të tokës apo hapësirave publike. Dhe e dyta bëj thirrje që Zyra ligjore të jetë pak më vigjilente në këto raste, sepse krejt asambleja po biem në lajthitje për një vendim", pohoi anëtar i Merturi.

Ndue Shabanaj, tha se mendoj që është dashur për ta korrigjuar këtë pikë të rendit të ditës: "Suspendimi i dy vendimeve të marra", unë kisha thënë: "Suspendim i realizimit të dy vendimeve". Se, nëse suspendojmë vendimet ne detyrohemi realisht ato vendime se rishqyrtohen prapë ose të merren prapë. Prandaj, edhe një herë duhet marrë vendime të reja, Nëse duhet për të marrë edhe një herë në rregull", shtoi prof. Shabanaj.

Avni Gashi, tha se e përkrah, por të mos na përsëriten herëve të tjera këso gabimesh.

Kryesuesi vuri në miratim. Me 24 vota për, pa asnjë votë kundër as abstenim u miratua kërkesa për suspendimin e dy vendimeve të KK.

Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullores për subvencione dhe transvere.

Kryesuesi Ibishi foli rreth çështjes në rend të ditë. Fjalën ia dha zyrtarit të lartë të ZL, z. Ali Shala që të flas rreth projekt-rregullores.

Ali Shala, foli rreth projekt-rregullores. Në vazhdim z. Shala tha se shkurtimisht dëshiroj të sqarohemi për pikën e mëparshme dhe t'ju informoj se në shumicën e rasteve po biem viktimë e nocioneve dhe viktimë e koncepteve në hartimin e pikave të rendit të ditës. "Pika e saktë e rendit të ditës që kaluam më parë do të duhej të ishte, Suspendimi i ekzekutimit të dy vendimeve për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë 99 vjeçar", në kuptim të vendimit të ligjshmërisë të MAPL-së, të cilin e kemi marrë me datën 25 maj 2015, si Shërbim i KK, edhe si Zyrë ligjore, e karshi këtij vendimi kemi obligim ligjor për ta bërë suspendimin derisa të kompletohen procedurat përkatëse ligjore Domethënë thjesht dhe shkurt: nuk kemi anulim të vendimeve të mëparshëm, por suspendim të ekzekutimit të tyre, pra suspendim të ekzekutivit të tyre, i realizimit siç e tha prof. Ndou në kuptimin tjetër. Prandaj, e kam thënë edhe në takimin me publikun edhe në KPF.

Haxhi Ibishi, vuri në miratim vendimin për korrigjim. "Kush është që të bëhet suspendimi i ekzekutimit të dy vendimeve të KK për dy kërkesat që na ka paraqitur MAPL, derisa të plotësohen procedurat.

Vuri në miratim propozimin. **Propozimi u miratua unanimisht.**

Ali Shala, në vijim foli rreth Projekt-rregullore për transvere dhe subvencione. Zyrtari Shala theksoi se iniciativa ka qenë e Kryetarit të Komunës, z. Sokol Bashota. “E kemi prurë tekstin. Kemi pasur takimin me publikun, e kemi shqyrtuar edhe në KPF etj. Në debatin me publikun janë dhënë vërejtje, sugjerime, këshilla dhe propozime që të gjitha me vend. I Kam konsultuar gjashtë komuna, në mënyrë për ta gjetur një model sa më të përshtatshëm për komunën tonë. Të gjitha komunat i kanë specifikat e veta. Është mirë që ta kalojmë shpejt dhe ta kemi këtë rregullore”, shtoi zyrtari Shala, i cili në vijim e sqaroi projekt-rregulloren nen për nen. Në vazhdim zyrtari Shala tha se ka qenë edhe kërkesë e qytet arëve në debatin me ta që shuma e caktuar prej 2 mijë euro e Zyrës së kryetarit të rritet, sepse nevojat emergjent e janë të shpeshta. Meqenëse edhe komunat të tjera kanë këtë shumë të caktuar. Mbi këtë shumë të caktuar prej 2 mijë eurosh me vendim vendos Asambleja Komunale”, pohoi zyrtari Shala, i cili, po ashtu në vijimësi duke folur rreth projekteve tha se përparësi kanë projektet me bashkëfinancim, po ashtu zyrtari Shala foli edhe rreth subvencioneve në lëmin e kulturës, të shëndetësisë etj. “Ligji mbi shëndetësinë, theksoi zyrtari Shala, është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, ndërkaq fjalën e fundit e ka Ministria e shëndetësisë”, sqaroi zyrtari Shala. Zyrtari Shala sqaroi edhe shumë çështje të tjera me rëndësi që kanë të bëjnë me këtë projekt-rregullore.

Sokol Bashota, foli rreth projekt-rregullore. “Deri me sot ndarja e subvencioneve është ndarë për ato kategori më të nevojshme, si për trajtimin mjekësor, aktivitete kulturore e sportive dhe aktivitete të tjera. Kërkesat i janë drejtuar drejtorive komunale. Për shkak të buxhetit të kufizuar jemi ballafaquar me shumë vështirësi. Problemi është që mbi 20 mijë euro nëse caktohen në kalendarin festave, unë mendoj që është mirë që të caktohet edhe limiti për to, e jo për të lënë mundësi të keqpërdorimeve dhe ato tek rastet në kulturës, kemi një festival “I këndojmë lirisë”, “Ora e Tahir Deskut” etj. Për cilindo aktivitet të propozohet sa dhe në cilin aktivitet. Te neni 11, pika 1.5, te punësimi i të rinjve, kjo nuk është e nevojshme për t’u përfshirë në projekt-rregullore si kategori, sepse ne e kemi numrin e përcaktuar të punëtorëve ose të shkruhet “punësim sezonal”. Për sport, përpos që kemi pasur dhe e kemi KF “Dukagjini”, tash kemi edhe volejbollin që duhet ndihmuar. Kosovës i kanë ardhur momentet për të dal jashtë dhe për të përfaqësuar në fushat e sportit, që është një e arritur e madhe, të precizohet sa ose të lihet hapur”, shtoi ndër të kryetari Bashota, i cili në vazhdim foli edhe për disa çështje të tjera tematike.

Ali Shala, theksoi se në rregullore nuk përcaktohen vlerat, sepse vlerat nuk qiten.

Halil Desku, tha se na bën nder miratimi i kësaj rregulloreje. “Nuk kemi pasur një rregullore të tillë dhe e mbështes miratimin e saj. Kam kuptuar se rregullorja është e mbështetur me ligj, në të janë përfshirë diskutimet e qytetarëve në debatin me publikun, janë hamornizuar me rregulloret, model me rregulloret tjera dhe i është përshtatur specifikave tona komunale. Nga këto fakte kam gjetur arsyen ta mbështes këtë rregullore. Kam një propozim që te neni 2 ku i jepet mundësia Kryetarit të subvencionojë mjetet në shumën deri në 2 mijë euro, propozoj që kjo shumë të jetë mbi 2 mijë euro”, shtoi ndër të tjera prof. Desku.

Avni Gashi, tha se ne disa anëtarë të KK kemi qenë pjesëmarrës si qytetarë në debatin me publikun, mirëpo këtu nuk po shoh se vërejtjet dhe sugjerimet e tyre janë përfshirës. “Rastet emergjente duhet trajtuar komisioni gjegjës. Mendoj që jo të gjitha kërkesat të shkojnë te Zyra e Kryetarit, kam konsultuar edhe rregulloret e komunave të tjera këtë kriter nuk e kam hasur. Ta bëjmë një rregullore të mirë. Ta qesim një rregullore në mënyrë që të mos na qet në lajthitje. Të fuqizohet komisioni. Duhet një linjë buxhetore. Ta bëjmë një rregullore të mirë se është për të mirë të të gjithëve. Kjo rregullore nuk i plotëson kriteret”, nënvizoi anëtari Gashi.

Sokol Bashota, theksoi se deri me tani subvencionet kanë qenë të decentralizuara. “Për gjithsecilin cent të shpenzuar në çdo moment mund të jap llogari. “Është me rëndësi kur kanë ardhur kërkesat për ndihmë, ka pasur raste kur kërkesat kanë ardhur edhe pas vdekjes. Rreth aktiviteteve kulturore, edhe përkundër shumë zërave që janë ngritur ne i kemi mbajtur, sepse janë në funksion të një funksionimi më të mirë. Rregullorja është e mirë dhe i kanalizon mjetet për subvencione. Deri me sot kërkesat janë bërë nga

drejtoria, janë diskutuar dhe është vendosur sipas mundësive buxhetore për t'i ndarë. Kaq janë mundësitë e Komunës për këto veprimtari të caktuara”, theksoi ndër të tjera kryetari Bashota.

Tunë Dedaj, theksoi se jam për të pasur mundësi sa më të mëdha për t'u ndarë mjete në raste të nevojshme. “Kërkesa që ju bëhet afaristëve për të ndihmuar veprimtari të ndryshme nuk është e keqe. Jam pro miratimit, sepse është në shërbim të mirë”, theksoi anëtarë Dedaj.

Qamile Qitaku, tha se kam vërejtje, sepse gratë nuk potencohen askund në aspektin gjinor, përveç te OJQ-të, mirëpo asnjë kriter nuk ka për subvencionet që duhet të përfaqësojnë edhe femrat, shtoi anëtarja Qitaku.

Arben Limani, theksoi se në emër të opozitës vërejtjet i prezantoi Avniu. “Nëse nuk merren parasysh vërejtjet për plotësimin e rregullores nuk di si ta votojmë. Prandaj, nëse nuk plotësohen kërkesat e opozitës, nuk do ta votojmë, nëse plotësohen do ta votojmë”, shtoi anëtarë Limani.

Halil Desku, tha se rregulloren jam për të miratuar. “Nuk kisha thënë të shkohet nen për nen, prandaj jam për ta votuar”, shtoi prof. Desku.

Kryesuesi vuri në miratim Projekt-rregulloren për subvencione dhe transfere.

Me 13 vota pro, 11 kundër u miratua projekt-rregullorja.

Haxhi Ibishi, theksoi se është një kërkesë që pika e shtatë e rendit të ditës të zëvendësohet me pikën e gjashtë, pra është kërkesë që të bëhet zëvendësimi i këtyre dy pikave të rendit të ditës.

Fadil Gashi, theksoi se ne veç në fillim kemi propozuar që të shtyhet krejt dhe ne nuk e votojmë dhe ashtu edhe kështu, se janë shkelur të gjitha procedurat. Domethënë veç për pozitën mbetet të votoni neve nuk na pengoni asgjë”, shtoi anëtarë Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim kërkesën për ndryshim të radhitjes së pikave të rendit të ditës, që pika 7 të zëvendësohet me pikën 6 dhe anasjelltas.

Me shumicë votash u miratua propozimi.

Haxhi Ibishi, sqaroi se opozita edhe ashtu janë deklaruar për kundër shqyrtimit dhe miratimit të pikës së rendit të ditës rreth Planit Zhvillimor Komunal.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Komunal.

Baki Gashi, foli rreth Planit Zhvillimor Komunal. “Falënderoj Urbani Plus-in për punën e madhe që kanë bërë në këtë drejtim. Dhe kisha lutur zonjës Ardita Byci Jakupi që të prezantoj rreth bëjë prezantimin rreth PZHK.

Vlora Tafilaj, tha se jemi duke shpejtuar shumë, sepse jemi duke i kaluar pikat e rëndësishme të ditës.

Ardita Byci – Jakupi, përfaqësuese e Urban Plusit, foli rreth Planit Zhvillimor Komunal.

Ali Shala, zyrtar ligjor, theksoi e drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe të Mbrojtjes së Mjedisit para disa ditësh ka bërë një propozim që rasti i tokës bujqësore në Këpuz dhe të Deiqit, të jenë me ndryshim të tretmanit, përkatësisht definimit të atyre dy ngastrave. Ligji mbi dhënien e pronës komunale ka një kriter të veçantë atje, meqë Ministria ka menduar asisoj, kështu që në tekstin formal dhe teorik të PZHK, sigurisht drejtori i Urbanizmit ka biseduar edhe me hartuesit e PZHK në mënyrë që të përfshihet kjo fjali rreth ndryshimit të destinimit, e mbi atë bazë ne kemi mundësi vendime të veçanta për procedurat e ardhshme”, shtoi zyrtari Shala.

Avni Gashi, tha se para 5-6 muajve na ka ardhur një procesverbal, na është premtuar se do të bëhet edhe një prezantim nga përfaqësues të kompanisë Urban plus-it. “Kemi marrë një CD që ka mbi 300 faqe dhe asgjë tjetër. Kjo është arsyeshmëria për të kërkuar dokumentacionin në vija të trasha. Pa një prezantim të mirëfilltë plani është jo përmbajtjesor”, theksoi ndër të tjera anëtari Gashi.

Skënder Merturi, tha se nuk mund ta votojmë një plan të tillë, duhet kohë për t’u marrë me këtë plan. “Ky plan na vlen për të gjithë. Nuk ia vlen për ta votuar këtë pikë pa një debat konsultativ, nuk e shoh të arsyeshme për ta votuar. Do të ishte shumë e dëmshme nëse ne e votojmë sot, nuk i shërben askujt ky PZHK i Klinës”, shtoi anëtari Merturi.

Fadil Gashi, theksoi se e para nuk është sot nëse vendimi kalohet, nuk është sot që miratohet një PZHK, por është vazhdimësi e një plani që ka ekzistuar që nga 2006, pikërisht Urban Plusi e ka punuar. “Për mua është akoma e paqartë se ne kemi dokumente që i kemi dërguar nga Shërbimi i Kuvendit dhe diku i thoni Plani Zhvillimor Urban, diku Plan Zhvillimor Komunal, madje diku edhe Rregullativ. Duhet për t’i sqaruar se çka jemi duke punuar dhe çka kemi para vetes. Shikoni me kujdes dokumentet që iu kanë ardhur anëtarëve të Kuvendit. Unë nuk po flas për ato që i ka Urban Plusi as për ato që i ka drejtorja. Ju po thoni se për këtë material është diskutuar edhe një herë vitin e kaluar. Unë po them: ne sapo shkelem një rend dite, sa shkelem një procedurë edhe miratuar Kornizën afatmesme buxhetore pa kaluar nëpër KPF. Jo rastësisht ne po ballafaqohemi me kërkesat e Ministrisë së Pushtetit Lokal, jo rrallë duke kërkuar për t’i anuluar vendimet tona që po i marrim. Duhet të keni kujdes për këto vendime, për këto diskutime, për këto procedura, sepse nuk është lehtë për të filluar procedurat e ndryshimit, sepse janë procedura, ligjit thotë janë të njëjta sikur kur hartohet prej fillimit. Dhe nëse shkojmë ne me kësi prezantime për t’i ndjekur Planin Zhvillimor objektet e jo objektet për t’iu përshtatur, sepse në Klinë është duke u kërkuar Planin Zhvillimor për t’iu përshtatur objekteve që po i ndërtojnë njerëzit me teke në mbështetje të pushtetit aktual, duke ua dhënë këta okejn nëpër tavolina dhe ky plan me iu përshtatur gjitha këtyre objekteve. Prandaj të keni kujdes sepse kështu nuk ka për t’iu ecur. E kanë të kotë, sepse ato që janë ndërtuar ilegalisht kanë për t’u regjistruar si ilegale”, nënvizoi anëtari Gashi.

Tunë Dedaj, tha se me dëshirën më të madhe PZHK për ta votuar edhe GP i AAK-së, edhe unë kërkoj në emër të grupit që ta shtymë për një ditë tjetër, sepse nuk jemi të përgatitur. “Ne kemi mundësi për ta dhënë një mendim çfarëdo, por nuk është në rregull, prandaj nëse e doni votën tonë atëherë duhet për ta shtyrë. Nuk ka asgjë te keqe po që se shtyhet për një muaj. Dhe nëse opozita e kërkon këtë shtyrje nga pozita kërkoj që të shtyhet”, shtoi anëtari Dedaj.

Halil Desku, tha se jam ardhur me dëshirën dhe vullnetin më të madh për ta votuar. “Pse? Sepse kemi filluar moti për të proceduar rreth miratimit të këtij Planit Zhvillimor. Dhe le ta dinë mirë këta opozita që po flasin kështu se ne i kemi mbështetur këta në kërkesat e tyre. Paraprakisht kur është kërkuar të shtyhet kjo, unë kërkoja mendimin e drejtorit të Urbanizmit. Thashë nëse janë gati duhet për të proceduar dhe duhet miratuar. Këta janë gati, ka ardhur Urban Plusi, kanë kërkuar Urban Plusin, ka ardhur Urban Plusi, kanë kërkuar materialin, ka ardhur materiali, kanë kërkuar CD, ka ardhur CD-ja, të gjitha ato që kanë kërkuar i kanë përpara. Prandaj, unë mendoj se është dashur për t’u përgatitur secili prej asamblistëve për ta votuar këtë plan. Nuk ka shtyrje më. Neve na nevojitet për të harmonizuar shumë gjera me PZHK. Prandaj unë i ftoj të gjithë që ta votojmë, ta miratojmë sot. Unë e pranoj një shtyrje nëse e kërkojnë përfaqësuesit të Urban Plusit. Nëse këta thonë se duhet proceduar unë jam për të proceduar dhe për ta miratuar”, konstatoi profesor Desku.

Rasim Millaku, tha se për hir të kualitetit kisha për të thënë, se ne si asamblistë, që shumica prej neve nuk jemi profesional që të vlerësojmë një plan zhvillimor, por për hir të kualitetit që duhet ta nxjerrim me një vendim edhe unë personalisht mendoj që për ta trajtuar më mirë Planin Zhvillimor. “Çfarë dua të shtoj lidhur me këtë? Planin Zhvillimor është punuar nga një kompani e cila ka përfutur për të bërë edhe një procedure të rregullt që ka aplikuar në tenderin, përkatësisht në ofertën e Komunës sonë. Ne nuk e kemi një mendim profesional të një grupi që ka vlerësuar këtë PZH, nuk e kemi një ndikim të grupeve të

tjera të cilët kishin për ta na shpjeguar neve se çka deri tash është vlerësuar kjo punë e grupit, pa dashur për të nënvlerësuar Urban Plusin. Neve na nevojitet, kisha për të thënë se Panin Zhvillimor Komunal duhet për t'u trajtuar si pikë e vetme në asamble ose të një grupi të cilët kanë mundësi për të edituar pak më mirë, të cilët kanë mundësi më tepër të marrin vesh dhe ta nxjerrim në miratim nëse është e nevojshme kualitativ. Unë për vete kam vetëm një CD që shumica prej anëtarëve prej neve edhe nuk kanë mundësi për ta hapur këtë CD. Ne nuk e kemi një raport, nuk e kemi një vlerësim të grupeve profesionale që sa ka punuar Urban Plusi pa dashur për të thënë as më pak as më shumë për ta, por Urban plusi ka dëshirë edhe secila kompani ka dëshirë për të kaluar sa më lehtë. Ta kryejnë punën e tyre, t'u thuhet "mirë". Ne nuk e kemi këtu asnjë "mirë", apo asnjë "keq", mirëpo unë e di që ka mekanizma plot që janë të kyçur rreth Drejtorisë së Urbanizmit, ata duhet për ta nxjerrë një vlerësim të gjendjes çfarë ka qenë, të gjendjes së tanishme dhe Urban Plusi më së paku ka nevojë për të na shpjeguar neve asamblistëve. Urban Plusi duhet ta shpjegojë punën, ose afër grupeve profesionale dhe dikush prej gjithë këtyre mekanizmave të na shpjegojë neve se çfarë duhet bërë. Është mundim që Urban Plusi të na shpjegojë, sepse shumica nga ne jemi joprofesional. Përndryshe, unë po them jam ithtar i nxjerrjes së një miratimi kualitativ nga aspekti i asaj që pak a shumë marr vesh se çka është PZH, nuk jam profesional në atë fushë, mirëpo nëse shkojmë vetëm për ta nxjerrë një miratim ne nuk kemi asgjë përpara. Nuk e kemi as minimumin e gjithë asaj që është punuar, pra nuk e kemi as minimumin e punës së çka është kryer deri me tash", nënvizoi anëtari Millaku.

Haxhi Ibishi, tha se unë mendoj që drejtoria që përfaqëson këtu ekzekutivin duhet për të qenë profesionale dhe ta jap mendimin e tyre profesional. Mendoj që edhe këta janë të gatshëm për ta dhënë atë mendim.

Baki Gashi, sqaroi se MPH e cila e ka këqyrë çdo detaj këtë PZH dhe e ka miratuar para 6 muajve. "Dhe ne kemi marrë edhe vërejtje pse deri me tani nga KK nuk është miratuar. Arseja që deri me tash ka mbetur kështu është sepse Plani Rregullativ Urban, kemi pasur disa vërejtje tona, por në bashkëpunim me kompaninë Urban Plusin kemi bërë përpjekje që të bëjmë atë më të mirën dhe kjo ka qenë arsye që deri me tani është shtyrë PZHK. Mirëpo PZHK është miratuar nga instancat më të larta shtetërore, përkatësisht nga ministria përkatëse e Planifikimit Hapësinor", shtoi drejtori Gashi.

Ardita Byci - Jakupi, prezantoi disa komente rreth Planit Zhvillimor Komunal të Klinës. "Sot jemi duke biseduar për Planin Zhvillimor të Komunës së Klinës. Atë që potencuan 2006 ka qenë Plani Zhvillimor Urban. Ky është Plan Zhvillimor i Komunës. Plus e përmendët edhe nivelin tjetër të planifikimit që është Plani rregullues, nuk kemi të bëjmë me atë plani, Plani rregullues do të vijë më vonë. Sa i përket zotërisë në lidhje, e potencuat edhe sipërfaqen, edhe historiatin, ky dokument është i hartuar në bazë të ligjit, lidhur me përmbajtjen e PZHK. Nëse kishte për të qenë ajo që po thoni, atëherë së paku prej ministrisë nuk do ta kishim marrë pëlqimin. Edhe tjetra, nuk flitet në nivel të sipërfaqes sepse është nivel më i lartë i planifikimit. Sikur të ishte në pyetje Plani rregullues urban atëherë ishte dashur ato informata për t'i marrë. Sa i përket prezantimit ne e kemi përgatitur prezantimin, që e keni të gatshëm që nga viti 2012, në këtë sallë është bërë prezantimi, mirëpo për shkak një mosmarrëveshje në mes të Komunës dhe Ministrisë kjo çështje është zvarritur. Ky plan mundet me qenë një model", sqaroi znj, Byci - Jakupi.

Haxhi Ibishi, kërkoi mendimin e Drejtorisë së Urbanizmit.

Baki Gashi, tha se PZHK është në rregull dhe të procedohet me votimin e tij. "Plani është miratuar nga MPH i cili në detaje e ka shikuar dhe ka dhënë miratimin e tij".

Skënder Merturi, tha se duke e ditur rëndësinë e e këtij plani, unë mendoj që ta shtyjmë. "Ajo zonja e tha se nëse na kërkohet edhe një herë të prezantohet ne mund të vijmë edhe ndonjëherë tjetër për ta prezantuar. Çfarë të keqe ka nëse që në seancën e ardhshme të bëhet prezantimi në mënyrë kompjuterike, në mënyrë vizuale qysh duhet për të shkuar një PZHK. Ne përgatitemi, e lexojmë atë material,

konsultohemi edhe ne me ekspertët tanë të fushës përkatëse dhe ne kur të vijmë, vijmë më të përgatitur. Sot nuk mund t'i japim vërejtjet, sepse jemi të pa përgatitur", shtoi ai.

Vlora Tafilaj, tha se nuk desha për të shtuar asgjë me shumë por vetëm desha për t'ju bërë me dije se ne jemi duke luajtur me të ardhmen e vendit tonë dhe nëse diçka shkon keq nuk dëshiroj që qytetarët e Klinës të bëjnë me gisht kah AAK ose kah LDK-ja. "Besoj që edhe Drejtoria e Urbanizmit nuk do ta marrë asnjë përgjegjësi për këtë".

Fadil Gashi, tha se për përfaqësuesen e Urban Plusit kam një sqarim: "Dokumentacionin e Komunës së Klinës nuk e di më mirë se sa unë, sepse e di çka është Plani Zhvillimor, sepse e kemi miratuar më 2006, prandaj i dallojmë si terme. Ne jemi laikë për ta ditur anën profesionale, teknike të PZH dhe të PU, sepse janë profesione të ndryshme. Këtë pjesën tjetër të jurispondencës ne e dimë më mirë se sa ajo. Ta kem të qartë, unë fola për dokumente të Shërbimit të Kuvendit, të mos referohet në fjalë të huaja dhe që nuk i takojnë asaj. Çështja tjetër: në nuk mund të miratojmë një CD çfarëdo qoftë. Nuk jemi kundër miratimit PZHK, sepse edhe ne e kuptojmë rëndësinë, por vetë fakti që doli edhe zyrtari ligjor dhe kërkoi për t'i qitur ato dy parcela, nuk bëhen krejt përmendsh këto punës, sepse nuk ka pritur për çdo gjë prej vitit 2012. Edhe unë kam qenë Kryesues në atë kohë, dhe pjesa më interesante është ajo ku kërkohet mendimi profesional që e kemi një ekip të ndërtuar, që ka për obligim për të dhënë mendimin, domethënë janë rrugët, janë procedurat që duhet për t'i pasur ky kuvend, kjo seancë, sepse dikush duhet për t'ia përgatitur dokumentin në mënyrë profesionale anëtarëve të Kuvendit, që në këtë rast mungon", shtoi anëtari Gashi.

Halil Desku, tha se shtyrja për një seancë qysh u propozua është ndalje e kohës dhe kjo do të thotë ngecje e zhvillimit dhe të harmonizimit të shumë projekteve që i kemi. "Ne këtu të gjithë e dimë sa jemi ekspertë, ne i kemi zgjedhur njerëzit në krye të Drejtorisë së Urbanizmit, është stafi i tij që janë me detyrë ekspertë të kësaj lëmie. Është edhe Urban Plusi që foli në cilësinë e kësaj çështjeje. Prandaj, ne duhet besuar edhe materialeve, qoftë CD, qoftë të shkruar, po ashtu qoftë edhe shpjegimeve të dy zyrtarëve, edhe të Urban plusit edhe të Urbanizmit. Po flas në emër timin personal dhe të GP të PDK-së të mos kohë se është humbje e zhvillimit të Komunës dhe nuk janë pak 30 ditë për të humbur. Prandaj, le të përfshihen sot se sa pas një muajve", tha prof. Desku.

Tunë Dedaj, tha se Halili është duke më befasuar për të aprovuar diçka që as vet nuk jeni duke e ditur se çka jeni duke e thënë, ai asamblisti juaj nuk ishte për ta shtyrë, dhe nuk bëhet asgjë nëse shtyhet. "Unë nuk di çfarë të votoj", pohoi ai.

Baki Gashi, MPH është instanca më e lartë e hartimit të PZHK dhe ata e kanë miratuar. "Ne nuk mund të bëjmë asnjë lloj ndryshimi në këtë drejtim, të cilët në mënyrë detaje e kanë shikuar këtë plan", pohoi drejtori Gashi.

Tunë Dedaj, drejtor më vjen keq, nëse është miratuar në instancat më të larta shtetërore, pse po e sillni tek ne për ta miratuar?

Avni Gashi, tha se pajtohem realisht atë që e tha Tuna më herët, drejtori tha "është miratuar". "Dhe, këtë shprehje e ritheksoi, prandaj neve na u drejtua çfarë jeni duke dashur të bëni këtu? Drejtori po thotë e kanë dhënë pëlqimin ata. Sikur ta kishin dhënë miratimin, atëherë është tjetër gjë, është e kundërta. Ju vendosni, i keni votat, i keni numrat keni mundësi për të proceduar. Arsyeshmëria është për ta shtyrë, problemi është se kjo është një lëmi goxha e madhe. Neve na nevojitet një prezantim si Asamble Komonale, ne duhet për ta parë nga kompania, e cila edhe ashtu është e thirrur për ta bërë atë punë, të na bëjnë një prezantim, prandaj komplet nuk kemi informata", pohoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, Janë dy qëndrime për të cilat kjo asamble duhet deklaruar.

Vuri në miratim PZHK . Me 13 vota pro, 10 kundër u miratua Plani Zhvillimor Komunal.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit komunal për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në fshat dhe qytet.

Kryesuesi Ibishi foli rreth çështjes së rendit të ditës dhe prezantoi Komisionin e caktuar nga KK për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në fshat dhe qytet. Në vazhdim kryesuesi Ibishi prezantoi përbërjen e Komisionit. Fjalën ia dha z. Zeqir Morina, drejtor i drejtorisë për meremetimin e rrugëve dhe shesheve në fshat dhe qytet të Komunës së Klinës.

Zeqir Morina, kryetari i Komisionit për emërtimin e rrugëve në fshat dhe qytet, prezantoi punën dhe angazhimin e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në fshat dhe qytet që ka bërë në terren. Kryetari i komisionit z. Morian e çmoi lart punën dhe angazhimin e këtij komisionit. Ai në vazhdim prezantoi edhe një regjistër me emra të ngjarjeve historike dhe të personaliteteve nga fusha e historisë, letërsisë, artit dhe të kulturës, me të cilët emra janë propozuar rrugët e lokaliteteve të komunës së Klinës.

Bajrush Shala, anëtar i komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në fshat dhe qytet, sqaroi shumë çështje që kanë të bëjnë lidhur me emërtimin e rrugëve nëpër fshatra dhe lokalitete të komunës së Klinës.

Rasim Millaku, theksoi se e çmoi punën dhe angazhimin e komisionit. “Komisioni edhe pse e ka pasur shumë të vështirë punën, ky komision ka kryer me dinjitet dhe përgjegjësi të lartë punën që i është besuar në emërtimin e rrugëve të fshatrave të Komunës së Klinës”, tha anëtari Millaku.

Tunë Dedaj, tha se në emër të GP të AAK-së e përkrah listën e Komisionit me emrat e propozuar të rrugëve të fshatrave.

Bozhidar Sharkoviq, theksoi se e përkrah listën e Komisionit. “Për Komisionin kam një vërejtje: rruga numër 49, gjatësia e rrugës është tepër e gjatë, propozoj që kjo rrugë që ka këtë gjatësi të sigurohet edhe një kod tjetër dhe të ketë dy kode dhe kodi tjetër të propozohet me një emër të ri”, tha ai.

Fadil Gashi, theksoi se është mirë për të shikuar Ligjin për VL cilat kompetenca ky Kuvend nuk ka të drejtë për t’i deleguar, që njëra prej tyre është emërtimi. Pjesa e dytë, ky Kuvend nuk ka të drejtë të propozojë listën rezervë. Në miratim të rrugëve, jo listë rezervë, lista rezervë të ndahet prek kësaj, ajo le të mbetet liste rezervë për komisionin, se hapen hapësira të reja. Pra listën rezervë nuk mund ta propozojmë”, theksoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, e sqaroi çështjen. “Lista rezervë të jetë për komisionin jo për Kuvendin. “Unë mendoj që në konfliktin e interesit si propozim kam që nuk voton ai që ka lidhjen e gjakut”.

Halil Desku, tha se e mbështes punën e komisionit, të cilin ne e kemi formuar, i cili ka dalë në terren dhe ka punuar bashkë me lagje, fshatra e kështu me radhë. “Nëse duhet ashtu për ta votuar si listë complete mund të shkojë pa vota, sepse të gjithë kemi familjarë këtu të cilët ne nuk i kemi vendosur. I kanë vendosur komisionet e fshatit bashkë me komisionin që kemi formuar ne dhe këta i kanë miratuar. Nëse shkohet emër për emër ne mund të tërhiqemi, por mendoj se duhet të shkojë si listë e kompletuar e komisionit. Prandaj nuk e di sa mund të ketë konflikt të interesit këtu dikush, kur ne nuk kemi qenë në komision fare, këto komisionet e fshatrave me komisionin tonë të përbashkët i kanë miratuar, ta gjëmë një zgjidhje”, tha prof. Desku.

Arben Limani, tha se tek Ligji për sistemin e adresave vetëm një plotësim desha për t’i bërë z. Fadil Gashi, që tha që lista rezervë të mos kalojë këtu në asamble, se edhe ligji e përcakton, domethënë neni 11 të lista e emrave rezervë, ku thotë: “Drejtoria komunale përgjegjëse harton dhe mban një listë rezervë”. Kështu është e definuar këtu te neni 11. Paraqita si shqetësim, në fillim të takimit edhe me drejtorin të emërtimi i këtij komisioni, nuk ka qenë një komision për emërtim të rrugëve, është komision për

rregullimin e sistemit të adresave. Edhe në rend dite ka hyrë si komision për emërtim të rrugëve”, sqaroi anëtari Limani.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes së kompensimit të komisionit. “Kjo çështje në disa komuna është rregulluar me vendim të veçantë. Kjo çështje duhet të paguhet”, pohoi Kryesuesi i cili në vijim dha edhe disa sqarime shtesë rreth disa vendimeve që janë marrë nga çështjeve të pagesë së paushallit për anëtarë të Kuvendit dhe shumë të tjera që duhet të zbatohen.

Arben Limani, tha se Drejtoria bashkë me Komisionin është munduar që gjatë kësaj periudhe për t’i njoftuar të gjitha lagjet dhe vendbanimet e Komunës sonë, nëse ndonjë lagje ose vendbanim nuk arritur për të prurë ndonjë propozim është përgjegjësi edhe e tyre. “Se ka ankesa, nuk janë ardhur propozim pra me shkrim, që kanë mundur për t’u shqyrtuar edhe nga komisioni”, theksoi anëtari Limani, i cili në vijim foli edhe rreth disa çështjeve që kanë të bëjnë për temën në shqyrtim.

Avni Gashi, tha se vetëm një pyetje e kam: kjo lista e mbiemrave është pak teknike, kjo me të kaltër, lista e fundit, numër 384, rruga “Dëshmorët e Zymberajve”, mos është gabim teknik, mos është menduar pak më ndryshe dhe nëse është përfundimtare le të rregullohet, se mbrapa nuk po ka logjikë”, theksoi z. Gashi.

Ndue Shabanaj, tha se ne i kemi marrë dy lista, njëën e morëm sot dhe njëën e kemi marrë me material, nuk e di ku është dallimi mes tyre. Megjithatë, komisioni kanë mundësi për të sqaruar këtë. Mendimi im është kështu: Të drejtën që kanë pasur për propozim janë qytetarët e secilit lokalitet. Këtë duhet për ta respektuar të gjithë edhe duhet për ta pasur parasysh edhe AK me rastin e vendimmarrjes, është respektuar kjo e drejtë apo jo. Aty ku ka ankesa të qytetarëve ose pjesëve të veçanta të lagjeve, nëse ata nuk kanë marrë pjesë në këto mbledhje ku janë bërë këto përcaktime për emërtim të rrugëve, është përgjegjësi e tyre personale, ose grupe, nëse nuk janë ftuar domethënë është dashur komisioni para se me i aprovua këto ishte dashur për t’i shqyrtuar këto. Këto besoj se i keni shqyrtuar ju dhe tash kemi ardhur në pozicionin ku duhet për ta marrë vendimin dhe nuk besoj se vijmë në pozitat të lajthitjes nga komisioni për të marrë një vendim, nëse pakënaqësitë janë të shprehura dhe realisht kanë bazën për t’u shprehur si pakënaqësi si të këtilla. Ne po dëgjojmë se ka pakënaqësi, komisioni e di më mirë, dhe qëllimi ynë është të respektohen të gjitha procedurat, të respektohet e drejta e qytetarëve për propozim, dhe, natyrisht kompetencat që ka Asambleja Komunale për të marrë vendim. Komisioni e ka kompetencën e vet. Te emërtimet që janë këtu të propozuara, mendoj që janë disa emra shumë të mëdhenj, në kuptimin e personaliteteve shumë të shquara kombëtare dhe të fushave të ndryshme, të letërsisë, historisë etj., që i vendosim këto lagje me emra, që është dashur ta kemi një udhëzim paraprak, para se të propozohen këta emra, megjithatë këtë çështje jam duke e thënë me vonesë, por dua ta them mendimin tim. Çështje tjetër është se disa emra që janë shumë të përgjithshme e që po i shohim këtu, nuk mund të kontestojmë të drejtën e qytetarëve për të propozuar, por ishte dashur komisioni që ta ketë parasysh këtë dhe për të zhvilluar bisedën me fshatrat për këto çështje, para se me ardhur në momentin e vendimmarrjes. Në fund dëshiroj ta them se më ka djegur çështja e konfliktit të interesit, çështja ime është bërë problematike, prej seancave të AK, deri te procedurat ligjore, gjyqësore etj. Mund të ketë konflikt interesi 100 herë dhe shumë konflikte të interesit të hapura plotësisht, por nëse nuk ka paditës, këto shkojnë në heshtje vazhdimisht. Pala që e ngritë këtë çështje me akuza të drejtpërdrejta qofshin ato ligjore ose politike, ose çfarëdo qofshin, atëherë vërtetë shqyrtohen secila prej tyre. Unë them se për këtë ishte dashur jo vetëm për këtë rast, por për të gjitha rastet Zyra ligjore në radhë të parë, AK përkatësisht udhëheqja e AK, në këtë rast Kryesuesi, ta ketë parasysh se edhe nëse ndonjë nga anëtarët e AK mund të mos jetë plotësisht i njohur me momentet kur mund të ndodhë konflikti i interesit t’ia bëjë me dije. Të mos vijmë në pozita të palakmueshme për gjerat të cilat janë fare të thjeshta dhe janë të nënkuptueshme dhe nuk është dashur të bimë në ato pozita. Këtu unë e di se ka shumë emra, që shumica prej nesh jemi të lidhur në aspekte familjare e të tjera dhe unë nuk e di kur ne largohemi kush mbetet ai për të marrë vendim. Edhe këtë çështje duhet ta kemi parasysh para se të shkojmë në marrjen e vendimit për këto emërtime. Dua ta

falënderoj komisionin për punën, për angazhimin, për të gjitha, por realisht ka shumëçka që në këtë proces të vendimmarrjes ishte dashur ta kemi parasysh këtë çështje”, konstatoi prof. Shabanaj.

Haxhi Ibishi, tha se kjo tregon se komisioni ka punuar në mënyrë profesionale. Kryesuesi në vazhdim foli edhe rreth disa procedurave që duhet të ndërmerren me rastin e vendimmarrjes rreth emërimit të emrave. “Tri vendime duhet ndërmarrë: Lista rezervë i mbetet drejtorisë; e dyta, 13 vende të zbrazëta komisioni i mbush prapë me propozime, nuk marrim ne sot vendim për këto 13 vende, ne marrim vendim minus 13 emërimet dhe marrim vendim jashtë listës rezervë”, shtoi Kryesuesi.

Halil Desku, propozoi që anëtarët që paraqesin konflikt interesi të dalin jashtë.

Zeqir Morina, tha se kjo listë që aprovohet apo nuk aprovohet, nëse aprovohet shkon në ministri atje, ministria i përfshin në sistem, mirëpo si do të mund që t’i pranojë kur nuk janë të përfshirë emrat rezervë.

Haxhi Ibishi, tha se emrat rezervë i çon drejtoria.

Marije Selamni, tha se nuk e kam të qartë, fq. 7, d.m.th. 274, dua t’i drejtohem Gjokës se ai i di ato treva më mirë, fshati Zllakuqan dy herë është përfaqësuar, këta emra që figurojnë nuk janë të fshatit Zllakuqan, por janë të fshatit Radulloc, nga kanë ardhur këta emra, nuk kam asgjë kundër, dëshiroj vetëm si sqarim.

Gjokë Lleshaj, në emër të Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në fshat dhe qytetet sqaroi çështjen e interesuar nga anëtarja Selmani.

Kryesuesi vuri në miratim listën e emrave të propozuar nga komisioni.

Me vota unanime u miratua lista e emrave të komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve të fshatrave dhe qytet.

Pika e tetë: Debati lidhur me Fabrikën e ujit në Klinë.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes në rend të ditës. Në vijim Kryesuesi kërkoi nga propozuesi i këtij debati që ta marr fjalën.

Avni Gashi, tha se unë kam shpresuar se do të jetë një raport që zakonisht mund të ndodh prej pyetjeve që kemi pasur, prej Kryetarit apo menaxherit të tanishëm që merret me këtë. “Megjithatë, unë do të ndalem te kërkesa jonë e opozitës para dy seancave kur kemi kërkuar të marrim kontratën. Kontratën e kemi kërkuar që kemi pasur dëshirë ta shohim, por e kemi kërkuar si shqetësim i qytetarëve të një investimi të përruar më shumë se dy herë, ku më saktësisht në këto portalet e shkruara më 25 korrik 2013 kur ka ardhur edhe zv.ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ferat Shala, i cili ka ndarë edhe 300 mijë euro, për t’u shtuar dhe rregulluar komplet kontrata e Fabrikës së ujit. Ne problemën kryesor e kishim që nuk kishim ujë të pijshëm ashtu siç është përgatitur. Klina nuk ka vuajtur pa ujë, por Klina ka vuajtur për ujë të pijshëm. Domethënë që problemi ekziston se qytetarët e Klinës nuk kanë pasur ujë të pijshëm. Dhe ne tjetër fuqi nuk kishim, neve nuk na mbeti asgjë tjetër përpos për t’i analizuar dokumentet, gjithë dokumentet përcjellëse që lidhen me kontratë. Këtu në këto dokumentet që na i keni sjellë, na kanë ardhur dy palë dokumente: është kontrata e dt. 12.7.2011, edhe procesverbali i dt. 3.6.2013, kur është bërë pranimi teknik i fabrikës. Në bazë të këtyre dokumenteve ne i kemi analizuar. Situatën faktike që është lëshuar Fabrika e ujit informatat qëndrojnë prej më të ndryshmet që është lëshuar, s’ka kapacitet, kalon ujët dika tjetër, është dashur për të bërë përrurime tjera, neve dëshirojmë për t’i dëgjuar prej zyrtarit përgjegjës të ekzekutivit. Unë në aspektin teknik do ta analizoj këtu çfarë kam mundur të shoh dhe çfarë jemi dakorduar si opozitë, disa probleme dhe ju me na i kthyer përgjigjet, pse qytetarët e Komunës së Klinës nuk kanë ujë që dy vite. Kur them që dy vite, nënkupton prej momentit kur është bërë pranimi teknik zyrtarisht, kur ka qenë në fuqi edhe garancioni për mirëmbajtje 710 ditësh, i cili korrespondon që në këtë muaj kalon pa u lëshuar fabrika pothuajse fare. Nëse bëjmë një parallogaritje

që për këtë kohë qytetarëve të Klinës iu ka kushtuar mbi 4 milionë euro duke blerë ujë ose barëra për shkak se nuk kanë pasur ujë të pijshëm ashtu si është me norma dhe standarde. Prandaj, e kemi kërkuar këtë debat për të na treguar se qysh qëndron puna, kur do të fillon ajo fabrikë, kur kemi për të pirë ujë, kur kemi për të qenë në gjendje për të pirë ujë prej çezmës”, shtoi anëtari Gashi i cili në vazhdim prezantoi dokumentet të cilat janë kërkuar nga opozita, cilat janë të sjella dhe cilat prej tyre mungojnë, ku sipas tij mungojnë shumë dokumente përcjellëse. “A është problem teknik apo nuk është problem teknik ka ndodhur që për kontraktuesin nënshkruan Abaz Foniqi, KK, ndërsa për autoritetin kontraktues, që në këtë rast është Komuna, nënshkruan është Nol Berisha. Nëse del kjo punë në gjyq, dikush nga gjykatësit kanë për të thënë se keni bërë një gabim komplet që keni ndërruar vendet dhe mund të thotë se kjo kontratë është e pafuqishme. Është një gjë që kemi vërejtur prej kontratës. Tash po i hymë rend dhe për t’i parë çka kemi diskutuar kontratën që kemi kërkuar nga ju. Çmimi 190 mijë euro inxhinieringu dhe menaxhmenti i planit detal ekzekutiv. Nuk kemi një dokument plotësues se çka është nënkuptuar me inxhiniering dhe menaxhment. 220 000 euro vetëm puna, nuk specifikohet çfarë lloj pune, pra shuma është përgjithësuese, shumë abstrakte; 45 mijë euro ndërtimi i fabrikës, është kontrata bazë që ne e kemi marrë; 61 mijë euro tubat për transport të ujit, deri ku tubat? 34 mijë euro ndërtimi i rezervuarit, a është rezervuari i Tikveshit apo rezervuari aty, pastaj e kam vërejtur se është edhe rezervuari i Tikveshit 5 mijë euro, plus 1 milion e njëqind mijë euro pompat, mbi 60 ose 70 për qind janë pompat, përkatësisht sistemi i pompimit, pjesa tjetër e ndërtimit të saj në totale 1.600. 950,00 euro. Kjo është shuma për të cilën jemi dakorduar dhe në nenin 2.3, çmimi i përmendur në këtë pikë duhet të jetë e vetmja pagesë e autoritetit kontraktues. Në pikën 2.4, ku thuhet “pagesat do të bëhen në pajtim me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës të dhëna në ofertën financiare dhe marrëveshjen e dt. 8.7.2011. Kontrata është nënshkruar tri ditë më vonë, tri ditë më herët është bërë një marrëveshje tjetër që ne nuk e kemi idenë se çfarë marrëveshje është bërë, ku neve na lë për të dyshuar që kjo paramarrëveshje i ka paraprirë që të mos kemi ujë. Ju do të keni mundësi të na sqaroni se çfarë marrëveshje ka qenë më herët që s’ka mundur për t’u përfshirë në kontratën bazike. Po i diskutoj vetëm këto dokumente që na i keni ofruar”, shtoi anëtari Gashi, i cili në vazhdim sqaroi dokumentet e ofruara nga ekzekutivi. “Në kushtet e veçanta në nenin 8.1, kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim programin e punës brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës. Ne nuk kemi parë diçka dokument dhe rrjedhimisht nuk kemi mundësi të të analizuar përpos këtë që po shohim. Është përcaktuar me kontratë për 95 ditë prej momentit prej kur ka filluar ndërtimi. Edhe me qenë ditë pune edhe ditë kalendarike janë kaluar të dyja. Inspektimi dhe testimi, menaxher Zeqir Morina. Fillimi i punëve, paradoksi i kësaj në kontratën bazike thotë (lexoi kontratën). Këtu nuk mund të kuptojmë asgjë se kur është përcaktuar data e fillimit të kontratës. Në këto kontrata duhet të kemi kujdes te këto nene dhe këto pika se janë të pakuptimta. 10.2 thotë data e përfundimit do të jetë 195 ditë që korrespondon me atë pikën e mëhershme. Nuk është e specifikuar puna kalendarike. Në këtë muaj i bëjmë 710 ditë të kësaj fabrike por i ka kaluar afati sepse pranimi teknik është bërë më 2013”, shtoi ai dhe vazhdoi rreth dëmeve të likuiduara te neni 19.1. që ka mangësi shumë teknike dhe këto mangësi teknike na kanë prurë komunën si palë kontraktuese të pafuqishme për ta shtyrë procesin tutje. Edhe tek të dhënat e përgjithshme na mungojnë shumë dokumente. (Lexoi një pjesë të kontratës që ka të bëjë rreth marrëveshjes në mes të palëve kontraktuese). Thjesht, në bazë të dokumentacionit kontrata ka mangësi jashtëzakonisht më mëdha çka edhe kemi dyshuar, nuk e kemi dokumentacionin e kompletuar që ne të jemi në gjendje të themi këtu ka qenë problemi. Tash Kryetari apo dikush tjetër do të na sqarojë. Ajo çka na shqetëson neve është se edhe 4 vjet pasi ka filluar financimi, Komuna e Klinës nuk ka ujë të pijshëm, shpresoj se do të marrim një përgjigje nga ekzekutivi, prej palës kontraktuese se ku ka ngelur problemi që s’kemi ujë”, nënvizoi anëtari Gashi.

Arben Limani, tha se kontrata është e përpiluar sipas ligjit mbi prokurimin publik dhe është një kontratë standarde, por neve si grup dhe si opozitë na interesojnë disa çështje specifike për të cilat ne kërkojmë edhe sqarime nga ekzekutivi. Vlera e kontratës figuron 1. 695000 euro, a është kjo shuma përfundimtare e pagesës që i është bërë operatorit, sepse në kontratë thuhet se kjo është shuma përfundimtare që do t’i paguhet kontraktuesit apo ka edhe pagesa tjera qysh edhe përfolët. Nëse ka edhe pagesa tjera, sa janë ato pagesa dhe për cka janë paguar ato, edhe a ka ndonjë aneks kontratë tjetër për pagesat tjera shtesë. Sipas

kontratës bazë te pjesa e tretë, kushtet e veçanta, afati për përfundimin e punëve ka qenë 195 ditë, ndërsa punimet nuk kanë qenë të përfunduara as kur është bërë pranimi teknik. Kontrata është nënshkruar më 11.7.2011, ndërsa procesverbalin e pranimit është bërë më 3.6.2013. Nëse punët nuk kanë përfunduar sipas kontratës ndoshta është dashur që të analizohet operatori ekonomik ashtu siç e parasheh edhe kontrata e jo të kundërtën të bëhen pagesat shtesë në llogari të operatorit ekonomik. Komisioni i pranimit teknik në procesverbalin e dt.3.6.2013 kanë konstatuar se ka ende punë të papërfunduara, siç janë blerja e gjeneratorit edhe shtrimi i kubëzave, d.m.th. riparimi i rrugëve në drejtim të Tikveshit deri të rezervuari i ujit. Pasi janë konstatuar punët e papërfunduara sipas kontratës bazë, si ka mundur të bëhet ky pranim teknik? Pse nuk ka edhe një aneks tjetër të procesverbalit të pranimit teknik? Për të konstatuar se këto punë veç janë përfunduar. Në mungesë të këtij aneksi të procesverbalit mund të vijmë në konkludim se këto punë nuk janë kryer asnjëherë së paku sipas letrave që disponojmë. Sipas kontratës bazë, pjesa e tretë, Kushtet e veçanta, thuhet se afati garantues është 710 ditë, pas pranimit teknik, e ne e dimë që gati 710 ditë pas pranimit teknik fabrika nuk ka qenë funksionale, që d.m.th. 710 ditshi tashmë ka kaluar. Meqë në procesverbal pranimi teknik në pjesën e përfundimit, konstatohet se fabrika mund të lëshohet në përdorim. Pse nuk është lëshuar në përdorim më 3.6.2013 e deri tash pasi kështu ka konstatuar edhe komisioni i pranimit teknik dhe organi tjetër mbikëqyrës”, konstatoi anëtari Limani.

Tunë Dedaj, tha se unë kisha dëshiruar për ta ditur a është lëshuar fabrika e ujit dhe kur qytetarët e Klinës do të kenë ujë të pijshëm.

Skënder Merturi, tha se unë kam disa pyetje lidhur me Fabrikën e ujit dhe mendoj që janë pyetje teknike që mund të përgjigjet drejtori i Urbanizmit ose dikush tjetër.” E para është pse mungon rrufepritësi në objektin e Fabrikës së ujit, kur dihet një zbrazje atmosferike shkakton dëme stabilimenteve që janë shumë të rëndësishme dhe shumë të kushtueshme që janë aty; pse mungon rrethoja e fabrikës; a ekziston leja për shfrytëzimin e ujërave nga ministria përkatëse, për shfrytëzimin e ujërave të lumit përreth ujit të lumit që merr ajo fabrikë dhe një tjetër i është drejtuar Kryetarit, pse mungon uji i pijes dy vite pas përfundimit të fabrikës që është përfunduar tash dhe kur dihet se fabrika iu ka kushtuar qytetarëve të Klinës rreth 2 milionë euro, edhe te dokumentet që nuk na janë dhënë neve, është që mungon Plani dinamik i punës, pse nuk na është dhënë ky dokument me këto dokumentet tjera”, kërkoi sqarime anëtari Merturi.

Sokol Bashota, tha se mendoj që ato që janë ndesh me ju përgjigjur, do të bëj përpjekje t’ju përgjigjem me përgjegjësi. “E para, i është parashtruar një kërkesë ekzekutivit dhe nga këtu parashtruesi i kërkesës del se më tepër është i interesuar për investigim në kuptimin tjetër, se sa një interesim për ta ditur se a është ujë i pijshëm apo jo dhe kur bëhet Fabrika e ujit në Klinë. Për ato tjerat nuk do të përgjigjem, por vetëm dua të tregoj një: Fabrika e ujit të pijshëm në Klinë kurrë nuk është përfunduar. Nga e keni marrë këtë informacion nuk e di. Nëse është ngatërruar përfundimi dhe pranimi teknik i aparaturës së ardhur nga jashtë kjo është diçka tjetër. Komplet kjo aparaturë duke u nisur nga pompimi dhe deri te sasia, cilësia e ujit e deri tek rezervuari i ujit të pijshëm në Tikvesh është bërë nga një kompani që është tenderuar nga Komuna që është ligjërisht e përcaktuar ashtu dhe kanë marrë pjesë ekspertë të lëmive përkatëse dhe kanë konstatuar se fabrika i plotëson të gjitha standardet. Dhe nuk ka pasur përfundim, inaugurim të fillimeve të punimeve po, por në asnjë mënyrë inaugurim. Më hyrë e për t’i marrë dy dokumentacione, janë dy kompani tenderuese që kanë ofertuar, njëra ka qenë rreth 1 milion e shtatëqind - tetëqind mijë euro, dhe tjetra 4.500000 për Fabrikë të ujit të pijshëm për Klinë. Dhe normalisht pasi është krijuar komisioni nga DU për vlerësim të ofertave është përzgjedhur kjo kompani që ishte më e leverdishme për Komunën e Klinës që edhe e ka standardin më të mirë. Kështu nga ky buxhet kemi kursyer rreth 3 milion euro se përndryshe kishim qenë të obliguar ta përzgjedhim edhe atë edhe me ato shuma më të mëdha për interesin e qytetarëve. Komunitet tjetër kanë siguruar ujë të pijshëm nga një fabrikë me kosto të shpenzimeve rreth 7 milionë euro, Komunës së Vushtrrisë aq i ka kushtuar dhe ende nuk është e kënaqur me kapacitetet që ka. Plani dinamik i çdo pune që fillon është i përcaktuar nga Urbanizmi dhe Zyra prokurimit, është në kontratë. Aty dihet kur fillon por në qoftë se ke pengesa në terren duke u nisur nga ato objekte dhe subjektive dhe dihet se ke pasur pengesa në implementimin e këtij projekti. Prandaj

duhet shikuar edhe ditarët e punës që ka pasur kjo kompani me gjithë punën dhe vlerësimin e komisionit mbikëqyrës. Prandaj këto zvarritje që janë bërë janë thjeshtë jo për shkakun e Komunës për arsye se ju e dini se janë siguruar mjetet dhe jo për fajin e operatorit se ai ka qenë i gatshëm dhe ai i ka kryer punët në afatin optimal. Por kemi pasur pengesa nga pronarët deri edhe tek pengesat e natyrave krejt banale, por që jemi përballur si ekzekutiv. Ajo që është inkurajuese për gjithë qytetarët e Komunës së Klinës edhe për ju që realisht nuk e di sa prej asamblistëve kanë qenë të interesuar për ta parë atë fabrikë, është e hapur dera aty, jo gjithherë për kureshtje, por edhe për të sharë kur i nevojitet dikujt, të gjitha punimet rreth kësaj fabrike kanë përfunduar. Dhe fabrika ka dy muaj që punon pa ndërprerë, ka më shumë bile, ka 3 muaj, dhe deri me tani është përdorur për qytetarët. Ju nuk ju keni bërë kurrë thirrje qytetarëve që ujin keni mundësi për ta pirë, për arsye se është përdorur njëkohësisht edhe ujët e Jerinës. Për ujin e Jeronës kemi shfaqur dyshimin se ai ujë nuk është i pijshëm dhe nuk kemi guxuar qytetarëve t’ju japim atë mundësi. Kjo ka qenë 3 muaj më tepër punë testuese e kësaj fabrike për ta ditur a është kapaciteti, a e prodhon, sasinë dhe pastaj në një moment të caktuar janë bërë edhe analizat nga Instituti Shëndetësor Publik i Prishtinës dhe është shumë inkurajuese se këta ujë që keni në ambalazhe nuk është më i mirë se sa ujët e Fabrikës së Klinës. Për këtë ju garantoj me përgjegjësi. Këtë e kanë thënë ekspertët, unë vetëm po transmetoj fjalën e tyre. Analizat ne mund edhe t’i sjellim dhe kapaciteti i fabrikës përmbush të gjitha parametrat e paraparë. Para 10 ditëve kemi formuar një komision të përbashkët në mes të Komunës dhe Hidrodrinit të Pejës për ta bërë pranim – dorëzimin e komplet këtij investimi vital që ka bërë Komuna e Klinës, ai inkason, ai merr të hyrat, ne kemi bërë investimet dhe dy komisionet janë duke punuar për t’i harmonizuar ligjërisht të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat që dalin nga kjo bartje të kësaj pasurie. Janë në përfundim e sipër leja mjedisore, mendoj që është kryer, një pjesë për kycje i bartet ligjërisht kompanisë Hidrodrini në Pejë për arsye se nesër ai do të thith të hyrat nga qytetarët, prandaj është në përfundim e sipër edhe bartja dhe asnjë problem tjetër nuk qëndron rreth Fabrikës së ujit të pijes në Klinë. Dhe shkëputja një herë dhe përgjithmonë nga sistemi i përbashkët edhe i ujit që vjen nga pusi i Jerinës edhe nga Fabrika, për arsye se kapacitetet e nevojshme për qytetarët, por jo vetëm për qytetin e Klinës por edhe për gjitha fshatrat përreth ka ujë të mjaftueshëm. Ajo që është shqetësuese dhe po na del në terren cdo ditë dalin humbjet që i ka Hidrodrini në rrjet. Deri tash nuk kanë pasur ndonjë element matës të këtyre humbjeve, fabrika e re nuk shkon në të njëjtin sistem, është e digjitalizuar dhe mund të menaxhohet nga shtëpia e një personi. Ata të Hidrodrinit nuk i dinë ato vatra nga është duke u harxhuar ujë. Humbjet janë marramendësi. Kjo fabrikë është bërë deri në Tikvesh, është bërë rezervuari i ri, dhe mendoj që nuk është absolut problem që qytetarët e Klinës kanë për ta siguruar ujët e pijshëm dhe ujë cilësor, edhe përkundër këtij rrjeti çfarë është. Aty ku ka mundësi për të ndërhyrë gjatë meremetimit të rrugës kryesore të qytetit, gypat komplet do të bëhen të modelit standardeve të BE-së, aty ku janë të tjerë duhet shikuar në të ardhmen. Thashë punë e ka komisioni i përbashkët në mes të kompanisë së Hidrodrinit dhe disa zyrtarëve komunalë, dhe ajo ka mbetur punë ditësh kur me u bërë pranim-dorëzimi, që ne mund ta lëshojmë atë fabrikë të ujit, mund t’u themi qytetarëve pini, por atëherë Hidrodrini nuk është përgjegjësi për shpenzime. Ajo madje – madje gjatë gjithë kësaj pune tremujore nuk ka pranuar borxhin e trafos e të rrymës që ka shpenzuar kjo fabrikë. Dhe e kemi problematikë kush ta marrë këtë borxh. Ne në këtë kontratë të pranim-dorëzimit jemi duke bërë përpjekje që të paktën se nuk e di sa do të funksionojë kjo, kjo kontratë e pranim – dorëzimit të kësaj fabrike për t’i paraparë një lloj rimbursimi modest, jo të Komunës, vlerën e investimeve të Komunës, por të paktën ajo për nevoja të veta për ta bërë për 10 vjet sa është kostoja e asaj fabrike për ta bërë rrjet në Komunën e Klinës, që ka plot fshatra të papërfshira me ujë. Kjo do të ishte e mirë edhe për ta edhe për komunën e Klinës dhe qytetarët e Klinës., pra edhe për vetë kompaninë se krijon të hyra më shumë. Ajo që është tjetër shqetësuese ne kemi raportin nga Hidrodrini ne jemi ndër tatimpaguesit më të pakët në rajon. Rrethoja është shqetësim edhe yni, është një vlerë 2-3 mijë euro, duhet për ta përfunduar. Është shtyrë, zgajtur dhe stërzgajtur më tepër se sa duhet, por në rrethanat çfarë kemi punuar jo për fajin edhe të operatorit e të komunës, pro më tepër për shkaqe teknike që kemi hasur në terren, në implementim, për arsye se kanë pasur për të kaluar nëpër prona private. Ata që janë marrë me këtë çështje, drejtori i Urbanizmit dhe të tjerët, kanë mundësi ta japin plotësime”, ka nënvizuar kryetari Bashota.

Fadil Gashi, tha se kjo çështje ka filluar moti për t'u debatuar dhe nuk është hera e parë po të njëjta fjalë Kryetari që i thotë, të njëjtat i ka thënë edhe herëve të kaluara pa hequr pikë as presje. "Vetëm një po i tregoj Kryetarit nëse nuk e ka lexuar atë që e tha "është bërë pranimi teknik vetëm i pajisjeve", kjo nuk qëndron, sepse Komisioni e thotë kështu në dokumente që na i keni prurë: "Përfundim: Ndërtimi i Fabrikës për sigurimin e ujit e pijes në Klinë është i ndërtuar në pajtim me rregullat e ndërtimeve të dokumentacionit teknik në bazë të kontratës në mes të palëve. Fabrika mund të lëshohet në përdorim. Domethënë thotë: "Fabrika mund të lëshohet në përdorim". Nuk është pranimi i pajisjeve, por pranimi teknik i fabrikës është bërë. Edhe emrat janë. Organi mbikëqyrës: Besart Gashi, Rasim Millaku dhe Ndue Sherri; Komisioni për pranim teknik: Shkëlzen Qorraj, kryetar, Bekim Lushtaku, anëtar, Halil Berisha anëtar, Esat Raci anëtar, Ali Gashi anëtar. Dhe në fund i nënshkruar prej menaxherit Zeqir Morina. Do të thotë kjo është kështu. Vërejtjet e evidencuara për punë e saktëson fabrika. Pjesa tjetër, zyrtarisht nuk e kemi bërë asnjëherë këtë pranim, e di që dy herë me keni ftuar mua, një herë më keni ftuar në debat kur kemi qenë, që keni thënë "për fatin e mirë të qytetarëve, por për fatin e keq të kundërkandidatëve i ftoj pasnesër për të ardhur në përrurim të Fabrikës së ujit". Kështu tekstualisht e keni thënë. Për me na ftuar na keni ftuar, për t'u përruruar e dimë që ujët nuk është bërë as sot se nuk është duke e pirë askush. Ky pranim teknik është bërë më 2013. Çka do që ka dalë punë shtesë 7 mijë, apo 20 mijë, është problem se kanë dalë jashtë pranimi teknik, pasi është nënshkruar pranimi teknik, sepse këto datat po sanksionojnë ditën kur është nënshkruar pranimi teknik. Po shpresoj për t'u lëshuar këto ditë, mirëpo ujë nuk ka dhe aq më keq se tash po thuhet se fabrika është duke punuar që 2 muaj dhe se ne qytetarëve nuk iu tregojmë ose pse s'ka ujë, lë të ndalet pusi i Jerinës dhe le të funksionojë vetëm fabrika. Këto nuk po na i sqaroni, sado po thoni se ujë është i cilësisë, dhe këtë nuk është duke e vënë në dyshim askush, nuk është duke folur për cilësinë askush se të gjithë e dimë që cilësia është e mirë. Pse keni bërë pranimin teknik? Keni hyrë me nënshkrim, keni hyrë në obligime ligjore para operatorit ekonomik, edhe a keni telashe ju me të? A keni një marrëveshje jashtë kësaj kontrate që operatori ekonomik është duke kërkuar edhe interesin e kamatës për vonesat e borxheve që iu janë bërë. Ju thoni jo, por pala tjetër, thotë po, këto të na sqarohen. Të na sqaroni, a i keni kryer të gjitha obligimet me operatorin ekonomik sipas marrëveshjes që keni pasur. Këtu është diçka duke ndodhur që nuk lëshohet ujët prej 2013. Kjo është çështje e interesit të qytetarëve edhe nuk është interes askujt. Nuk po dua të besoj, sikur gypat që i keni nisur në drejtim të Istogut pa pasur projekt, debat, pa pasur marrëveshje me askënd, që janë hyrë 20 apo 300 mijë euro në dhe. Nuk dëshiroj të besoj sikur në Gllarevë që janë dërguar deri në Gllarevë për ujë të pijshëm, ujët nuk është, 300 mijë euro sa kanë hyrë në dhe. E keni ujësjellësin prej 2004 që është investuar për Volljak as sot s'ka ujë. Unë po besoj se nuk keni telashe me kompaninë, ashtu siç po flitet, ashtu siç na thotë pala tjetër. Ne kemi dëshirë për të qenë pale me ju, jo me atë, mos ta ngatërrojnë. Ne kemi dëshirë me qenë palë me ju e jo me operatorin ekonomik. Ju merreni si të doni", ka konstatuar anëtari Gashi.

Sokol Bashota, tha se asnjë problem nuk kemi me kompaninë investuese të jeni shumë të sigurt. "Kompania nuk i ka marrë paratë vetëm për atë garancën që ka, që është ligjërisht e sanksionuar në kontratë. Dhe është vetëm çështje teknike se kur Komisioni i përbashkët mes Hidrodrinit dhe Komunës, ta kompletojnë bartjen për dhënien nën menaxhim, se ata nuk e pranojnë as këtë borxh të rrymës diku rreth 9 mijë euro të trafosë, nuk e pranojnë përderisa e kanë nën menaxhim. Prej momentit kur ata e marrin nën menaxhim, janë përgjegjës pastaj edhe për cilësinë, për sasinë etj. Fabrika si fabrikë i plotëson të gjitha standardet i verifikuar edhe nga një komision profesional", sqaroi kryetari Bashota.

Baki Gashi, foli rreth çështjes së Fabrikës së ujit të pijshëm. "Kompania Hidrodrini është neglizhente, se humbjet e tyre janë të mëdha. Mos pranimi është për shkak të humbjeve në terren. Kompania i ka kryer punët sipas marrëveshjes dhe jemi përgjegjës prej aty deri në Tikvesh. Prej Tikveshit e në shtrirje të rrjetit absolutisht nuk është në menaxhimin tonë. Kjo është e vërtetë. Deri me sot drejtori i Hidrodrinit akoma nuk ka qenë për ta vizituar ta shoh bile në mënyrë vizuale fabrikën, një dhuratë që ia jep Komuna e Klinës në menaxhim. Tani kemi formuar një komision i cili i kryen punët brenda një kohe shumë të shkurtër. Analizat na kanë ardhur të mira, tepër cilësore", shtoi drejtori Gashi.

Avni Gashi, tha se realisht në bazë të diskutimeve që u bënë kërkesa për debat ka qenë jashtëzakonisht e rëndësishme, edhe e nevojshme. “Pjesa e dytë, e cila ka të bëjë me transferimin e pronës tek Hidrodrini me problemet që ballafaqohet, me humbjet, janë pjesë jashtë këtij diskutimi, jashtë kësaj lëmie për të cilin ne kemi thirrur debatin. Ne e kemi thirrur debatin me një investim prej 1.6 95,000 euro, minus 10 për qind, 1.50000, që është bërë për të pasur ujë të pijshëm në Komunën e Klinës. Sa do t’u kushtojë qytetarëve të Klinës kjo neglizhencë e dikujt? Që dy vjet prej momentit që është e pranuar teknikisht fabrika, thashë më parë, tash edhe për procesverbal po e llogarisim, nëse llogaritim 30 mijë banorë që pinë 11 ujë që kushton 20 centë në ditë, 30 mijë herë 20 centë bëjnë 6 mijë euro, herë 365 ditë, bëjnë 2.190,000 herë dy vjet bëjnë 4400 mijë euro, 44 0000 euro janë që neve si komunë e Klinës po na kushtojnë. Nëse nuk i paguan Komuna me taksa i paguan qytetari i Komunës së Klinës. Kjo është ajo e papranueshme dhe që duhet gjithqysh për ta gjetur një zgjidhje. Pjesa e dytë nuk e arsyeton pjesën e parë, kjo është çështje komplet tjetër, mos t’i përziejme gjerat”, tha anëtari Gashi.

Rasim Millaku, tha se për hir të informimit të saktë, po flas si pjesë e mbikëqyrjes së kësaj fabrike, domethënë si organ mbikëqyrës, kam qenë unë dhe dy të tjerë që u potencuan, dhe janë në procesverbale. “Kisha për të thënë që fillimisht të shihet dokumenti i qartë, është pranim teknik i përkohshëm, nëse keni marrë tjetër, nuk është ai që unë kam edituar në të, por është një lloj pranimi teknik i përkohshëm thirrret. Ka shumë probleme gjatë kohës së mbikëqyrjes po që se dëshironi të gjitha një nga një mund t’ju them, por besoj se të gjithë i dimë, duke filluar prej pengesave që dimë ne për t’i pasur ose që dimë për t’i bërë. Kemi pasur pengesa në shtrirje të gypave, kemi pasur pengesa fizike, prej KEK-ut, po flas në kohën e mbikëqyrjes. Me javë ose me ditë tëra në momentin kur ka filluar fabrika kemi pasur probleme të riaktivizimit mbi trafo të vjetër, dhe diku rreth 1 muaj kemi bërë për ta kyçur, përkatësisht trafon për ta aftësuar në mënyrë që operatori për të filluar për ta shfrytëzuar atë trafo aty. Të gjitha këto janë probleme teknike. Si investim i Komunës dhe unë si pjesë e organit mbikëqyrës, po flas edhe në emër të atyre dyve që nuk gjenden këtu, jemi përpjekur maksimalisht dhe kemi arritur deri në masën 100 për qind të realizimit të atij projekti, domethënë realizimit të punëve sipas projektit, po flas deri 100 për qind janë sipas projektit. Ka vonesa, është lëshuar kjo fabrikë disa herë, është lëshuar për testim, është lëshuar për verifikim, ndoshta edhe ne si organi shpeshherë kemi dyshuar dhe kemi dashur shumë para kohe për ta testuar dhe për të parë çfarë po ndodh me këtë fabrikë. Por gjithmonë na ka rezultuar një punë çfarë edhe kemi përcjellë edhe e suksesshme, domethënë si fabrikë. Duhet të bëhet një pranim final, ndoshta edhe një përrurim simbolik, edhe një pranim final, sepse ne si komision kemi qenë të shtrënguar mos me edituar më shumë pa kompletuar, se operatori ankohej nuk kam mjete për ta blerë gjeneratorin, nuk kishim guxim të qesim mjete pa e parë gjeneratorin, dhe shtyeshim, po flas deri më 2013. Por, si projekt dhe realizimi i punimeve, duke filluar nga fabrika, nga themelet, armaturës, është realizuar deri në masën 100 për qind. Aparaturat që kanë qenë shumë risi për ne, ekspertët kanë ardhur nga Prishtina dhe nuk i kanë njohur ato aparatura, edhe për profesorët e fakultetit kanë qenë risi. Kemi dashur për të shkarkuar përgjegjësinë kemi ftuar trupë profesionale për t’u bërë verifikimi, kanë verifikuar dhe kanë një proces. Është një draft që tregon për aparaturat që janë të ardhura nga Holanda, sepse ne si organ vendor nuk kishim ditur për t’i verifikuar. Vonesa ka. Po që se është duke punuar le të thuhet fuqimisht se është duke punuar, nëse nuk është duke punuar të thuhet se nuk është duke punuar. Kisha lutur Kryetarin dhe gjithë këta nëse është lëshuar fabrika për ta vërtetuar qoftë edhe prej një trupe këtu për ta parë fabrikën që është duke punuar. Të shkohet të vizitohet dhe ta lëmë këtë temë. Të verifikojmë që fabrika është duke punuar, i ka kapacitetet, nëse është konstatuar se janë mbërritur kapacitetet, të bihet një letër edhe të bëhet një pranim i përgjithshëm edhe përfundimtar edhe për ta hequr përgjegjësinë se është një investim i Komunës dhe ia vlen për t’u marrë sinqerisht me këtë investim, me lënë me krenari këtë investim. Probleme ka pasur gjatë gjithë kohës. Jemi shtyrë me operatorin, mirëpo ka dalë një projekt çfarë e tha Kryetari. Nëse punon fabrika është mirë të thuhet fuqimisht edhe të thuhet me dokumente”, theksoi anëtari Millaku.

Avni Gashi, tha se Rasimi ka qenë pjesë e projektit. “Vetëm te fjala “i përkohshëm”, të sqarohet, ne pamë që mungojnë 100 dokumente. Thuhet në fjalinë e fundit para se të nënshkruhet: (lexoi dokumentin).

Deshëm e s'deshëm ne jemi në pranimin teknik përfundimtar sepse nuk kemi zgjidhje tjetër me këtë dokument", tha anëtari Gashi.

Tunë Dedaj, tha se me sa e kuptova unë kryetarin fabrika është e lëshuar, edhe ujët është i pijshëm, edhe kisha kërkuar që të informohen qytetarët dhe ta përdorin ujët.

Skënder Meturi, tha se debatin e dëgjova me vëmendje edhe fjalët e Kryetarit, por ne jemi duke e mbyllur këtë debat pa ditur, pse s'ka ujë të pijshëm. "Boll u tha këtu, por arsyeja kryesore se pse s'ka ujë nuk u shpjegua. Ujë, kryesorja nuk ka ujë, na flasim ç'a dëshirojmë, por ujë nuk ka", tha anëtari Merturi.

Sokol Bashota, tha se ndoshta gjerat dëshironi për t'i prekur me dorë, unë ju ftoj të gjithë për të shkuar në fabrikë tash, për ta parë kapacitetin. "Në nuk mund të gënjejme. Nuk e marr përgjegjësinë unë përderisa nuk mund ta menaxhojë unë si komunë. Le të ma lejon ligji ta menaxhojë unë dhe për ta faturuar unë, me e rimbursuar unë si Komunë, unë e lëshoj sonte. Deri sa ta barti, kjo është punë ditësh, komisioni është krijuar që 10 ditë, dhe janë duke punuar në mënyrë intensive për ta bërë bartjen. Dhe unë e them më shumë se sa kjo, edhe tha edhe Rasimi, janë prerë gypat më sëpatë, kemi pasur probleme nga më të ndryshmet, më banale, dhe opinioni nuk e ka marrë vesh sepse nuk kemi dashur për të shkuar deri në atë shkallë sa... Shikoni, unë dy herë kam gjetur këtë Komunë duke u djegur! Flakën ia kanë shtirë! S'ka pasur atëherë kamerë. S'po flasim për pengesat që dalin në terren. Se nuk është mirë as për të mirën e përgjithshme as atë vendore. Ujë tash shkojmë në fabrikë, nuk mashtrojnë aparaturat ty, në digjitale janë krejt, sa çon në Tikvesh. Sa ka humbje nuk është në përgjegjësinë tonë, por deri në rezervuarin e Tikveshit, ujët është qind për qind të pijshëm dhe më i mirë se cilindo ujë që ka sot rajoni. Dhe që 3 muaj fabrika ka nisur për të punuar me 150 metra kub në orë duke bërë pastrimin e filterëve. E thashë, fabrika e ka kapacitetin e duhur në bazë të kontratës për ta furnizuar qytetin dhe qytetarët e Klinës. Kjo bartet shumë shpejt dhe pastaj hiqet përgjegjësia e komunës. Fatkeqësia më e madhe është, se a do të kemi mundësi për t'iu dhënë falë, apo me pasur mundësi për të nxjerrë ndonjë investim shtesë për qytetarët. Ndërsa përmes kompanisë Hidrodrini janë 9 fshatra të tjerë që është një projekt i huaj si donacion që e kemi thithur për të investuar në disa fshatra të Komunës sonë. Po që se dëshironi për të shkuar shkojmë te fabrika për ta parë kapacitetin në vend", konstatoi kryetari Bashota.

Haxhi Ibishi, prezantoi një informatë se AKK i kanë dërguar qeverisë një shkresë për një ngritje të këtij paushalli të këshilltarëve dhe në atë shkresë është dhënë edhe një informacion që mbetet në hartimin e buxhetit komunal komisionet që i formon Kuvendi mbetet që komunat vetë për t'i kompensuar.

Tunë Dedaj, tha se në emër të GP të AAK-së kam një kërkesë për të marrë një vendim për të vendosur disa pllaka, përkatësisht tabela, për lajmërime, në 5-6 vende në qytet, për lajmërime për njerëzit që vdesin dhe çështje të tjera. "Ato të jenë të mbyllura, është kulturë, atëherë mos të lejohet për t'i vënë nëpër shtylla elektrike etj.", shtoi anëtari Dedaj.

Kryesuesi Ibishi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë. Seancën e konstatoi të përfunduar. Seanca përfundoi në orën 16.00.

Procesmbajtësi,
Mikel Gojani

